

Procesverbal

*Nga Mbledhja VII (e shtatë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më datë:
29.07.2025*

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raporti i Auditorit të Jashtëm;
3. Plani i Veprimit të Auditorit të Jashtëm;
4. Raporti Financiar i Shpenzimeve për periudhën janar-qershor 2025;
5. Informatë lidhur me punën e KKSB-së për periudhën janar-qershor 2025;
6. Rishqyrtimi i Vendimit 01Nr.060/01-11859-2/25 të datës 30.06.2025 për miratimin e Listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Dragashit;
7. Shqyrtimi i kërkesës së z.Burim Piraj për ndërrimin e destinimit të tokës; dhe
8. Eventuale.

Arijeta Skeraj: I nderuar kryetar, të nderuar kolegë asambleistë, përfaqësues të OSBE-së, mediave, dhe të pranishëm të tjerë! Ju uroj mirëseardhje në seancën e shtatë të rregullt të Kuvendit për vitin 2025! Besoj se materialin për këtë seancë e keni pranuar me kohë dhe keni pasur mundësi të njiheni me përmbajtjen e tyre. Në rendin e ditës kemi gjithsej shtatë pika dhe pikën eventuale. Të nderuar të pranishëm, para se të vazhdojmë me punimet e kësaj seance, më lejoni që në emër të Kuvendit të Komunës dhe në emrin tim personal të shpreh ngushëllimet më të sinqerta për ndarjen nga jeta të kolegut tonë të nderuar, asambleistit, z.Mehmet Spahiu. Ndër ne, ai do të kujtohet si njeri i përkushtuar, me integritet, që dha kontribut të çmuar në jetën institucionale dhe publike të Komunës sonë. Qëndrimi i tij korrekt, angazhimi i palodhshëm dhe mendimi i matur ishini gjithmonë një vlerë e shtuar në diskutimet tona. Humbja e tij është e rëndë jo vetëm për familjen dhe të afërmit, por edhe për ne si kolegë, për të gjithë qytetarët që ai i përfaqësoi me ndershmëri. Në shenjë nderimi dhe respekti për jetën dhe veprën e tij, ju ftoj për një minutë heshtje! ...Lavdi!

Sot kemi një mysafir special i cili na ka nderuar me pjesëmarrje në zhvillimin e punës së kësaj seance – zëvendësambasadorin, z.Mehmet Buldanli, të cilin e përshëndes për zemërsisht, pasi në kohët më të vështira të Republikës sonë, e në veçanti të Komunës sonë, na është gjetur në ndihmë. Para se ta qesim në votim rendin e ditës, e ftoj kryetarin e Komunës që ta marrë fjalën.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese e Kuvendit, i nderuar zv/kryesues, të nderuar delegatë, përfaqësues të OSBE-së, media! I nderuar dhe shumë i respektuar, Mehmet Buldanli, miku i shqiptarëve, goranëve dhe boshnjakëve, miku i Kosovës dhe miku i Komunës së Dragashit! Kam nderin dhe kënaqësinë që para jush ta prezantoj një person i cili, në kohërat më të vështira i ka ndihmuar popullit të Dragashit. Ky është Mehmet Buldanli, është zëvendësadministrator i Komunës së Dragashit, i cili ka qenë prezenet këtu nga viti 1999 deri në vitin 2005. Me z.Mehmetin kemi pas një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë. Unë një kohë kam qenë edhe drejtor i Drejtoratit për Shëndetësi, pastaj edhe Kryeshef i Ekzekutivit. Gjatë tërë asaj periudhe kemi pas një bashkëpunim të mirë. Mehmeti është një mik shumë i madh i Komunës sonë dhe të tri etnive që jetojnë në Komunën tonë. Gjatë kohës kur Kosova ka qenë nën protektorat ndërkombëtar, ky e ka ndihmuar popullin e Kosovës, në fillim me ndihma humanitare – edhe materiale, edhe monetare. Ka pru shumë donatorë edhe investitorë në Komunën tonë. Unë ma shumë nuk dua ta zgjas, e kisha lut z.Mehmet Buldanli që të dalë në foltore dhe ta marrë fjalën.

Mehmet Buldanli: I nderuar kryetar, i nderuar nënkryetar, të nderuar asambleistë dhe të gjithë pjesëmarrësit e tjerë! Ju falënderoj të gjithëve për mundësinë që ma keni dhënë të shprehem sot para jush! Për herë të parë në Kosovë kam ardhë në vitin 1999, si një gurbetçi në vendin tuaj. Mirëpo, tani këtu është shtëpia ime. Kryetari i Komunës suaj është një mik i imi i vjetër. Së bashku kemi bërë shumë punë të mira, në të dy anët, në Opojë dhe në Gorë. Në mesin e tyre ka pas shumë punë të mira, si për shembull, ndërtime dhe ndihma të ndryshme. Kështu që, kam shumë kujtime me vendin tuaj. Nuk mund të kaloj pa e përmend të paktën një nga kujtimet. Në kohën kur UNMIK-u administronte këtu në Komunë, në hyrje të Komunës ishin dy flamuj. Njëri ishte flamuri i UNMIK-ut, tjetri flamuri i Shqipërisë. Shefi i UNMIK-ut që ishte këtu në Dragash më tha që duhet ta heqim flamurin e Shqipërisë dhe ta lëmë vetëm flamurin e UNMIK-ut. Unë i thashë që në, kulturën time, vdiset për flamur, unë nuk mund të prek asnjë flamur të askujt, e as nuk mund ta ul asnjë shtizë të asnjë shteti. Pas asaj kohe, ai e pranoi dhe askush nuk pati mundësi ta prekë atë flamur, që të ulë poshtë. Ju falënderoj edhe një herë për mundësinë që ma dhatë të shprehem sot para jush! Ndoshta edhe tash e mbas do të kem ndonjë mundësi që edhe më shumë të bëj punë të mira për vendin tuaj. Ju falënderoj shumë!

Xhylferie Bahtijari Beqiri: z.Mehmet, edhe ne të falënderojmë edhe për kohën kur keni punuar këtu, edhe për tani që po vazhdoni më mbështetjen tuaj për Komunën tonë!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Para se të kalojmë te shqyrtimi i rendit të ditës, a do dikush me e marrë fjalën rreth rendit të ditës?

Shpetim Hajredini: Përshëndetje ekzekutiv i nderuar, kolegë/e asambleistë/e, qytetarë të nderuar të Dragashit! I nderuar Mehmet Buldanli, ish-administrator në Komunën tonë! Të nderuar bashkatdhetarë që tani gjendeni në Komunën tonë në veçanti, e në përgjithësi në tërë Kosovën! Ju dëshiroj mirëseardhje dhe shpresoj t'i kaloni këto ditë pushimi si është më së miri! Në emër të Grupit të PDK-së dhe në emrin tim personal i shpreh ngushëllime familjes së kolegut të nderuar, Mehmet Spahiut! Dhashtë Zoti e ka mëshiru edhe e ka shpërbly me Xhenet! Me kaq po e përfundoj këtë fjalim, pastaj e vazhdojmë me pikat tjera. Ju faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, siç e keni marrë materialin, i kemi shtatë pika të rendit të ditës dhe pikën eventuale. Kush është pro rendit të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 23 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Vazhdojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Në qoftë se jo, e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 23 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë pikën e parë. Vazhdojmë me pikën e dytë: Raporti i Auditorit të Jashtëm. E hapi diskutimin!

Shpetim Hajredini: Atëherë, së pari duhet të ju kërkoj falje për shkak të gjendjes shëndetësore, do të mundohem në maksimum që të jam i shkurtë dhe sa më i qartë. Atëherë, natyrisht që në këtë pikë të rendit të ditës po diskutojmë për një dokument shumë të rëndësishëm, i cili për në besoj që tregon pasqyrë të qartë se ku gjendet Komuna jonë. Do të mundohem shumë shkurtë të paraqes atë që auditorët e kanë paraqitur në materialin të cilin na kanë dërguar neve, por që realisht qytetarët nuk e dinë. Do të dal direkt tek gjetjet edhe rekomandimet që besoj ju interesojnë të gjithëve, se këtu është ajo pika kyçe ku tregon saktësisht se në çfarë gjendje gjendet Komuna. “Gjatë procesit të auditimit kemi identifikuar disa fusha ku mund të përmirësohet performanca, duke përfshirë kontrollin e brendshëm. Testet tona kanë treguar që nevojiten përmirësime në respektimin e rregullave financiare për pagesën e faturave brenda afateve ligjore, menaxhimin e kontratave, menaxhimin e pasurisë, menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, kompletimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe klasifikimin e saktë të shpenzimeve. Shuma e pagesave të realizuara nga thesari në bazë të vendimeve gjyqësore përmbartimore për kontratë kolektive është 45,110 euro, prej tyre borxhi kryesor ishte 29,363 euro, ndërsa 15,747 euro ishin shpenzime procedurale të gjykatës-përmbartimit”. Raporti i Auditimit ka rezultuar gjashtë rekomandime, ku

prej tyre tri rekomandime të reja dhe tri rekomandime të përsëritura. Mirëpo, për këtë do të diskutojmë në pikën tjetër. Tani do të mundohem të kyçem dhe të diskutoj për të vitit të kaluar, pra të vitit 2024. Në vitin 2024 ka pas më pak gjetje dhe këtë vit kemi më tepër gjetje. Mirëpo, ajo që na intereson më së shumti neve është që të shohim se cilat prej atyre gjetjeve të vitit 2024, ekzekutivi ka arritur t'i zbatoj dhe që gjetjet të mos jenë më në këtë vit. E para, fusha e auditimit ka qenë të hyrat dhe rekomandimet e atij viti kanë qenë që: kryetari i Komunës duhet të shtojë kontrollin lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, duke vlerësuar të gjitha kontratat, njëherit të sigurojë se dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim bëhet sipas kërkesave të Ligjit për Shfrytëzimin dhe Kombinimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Në bazë të Auditorit, kjo e gjetur më nuk ekziston, pra është zbatuar plotësisht nga ana e ekzekutivit. Mallrat dhe Shërvimet dhe komunalet: kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individualë për shërbime të veçanta, duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbushë detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit. Veprimët e ndërmarra: janë zvogëluar obligimet e papaguara në krahasim me periudhën paraprake. Pra, edhe këtë e kemi zbatuar. Tek pasuritë, ka qenë si gjetje, ndërsa rekomandimi i Auditorit ka qenë: kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e saj të jenë të regjistruara në regjistra përkatës, si dhe për pasuritë nën 1000 euro duhet të sigurojë që janë aplikuar normat e zhvlerësimit, në mënyrë që prezantimi i tyre në pasqyrat financiare vjetore të jetë i plotë dhe i saktë. Nuk janë ndërmarrë veprime, po thotë Auditori, nuk ka filluar zbatimi. Llogaritë e arkëtueshme: kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë, me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet të shqyrtohen të gjitha masat në pajtim me Ligjin ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet. Nuk janë ndërmarrë veprime. Nuk ka filluar zbatimi. Auditori po thotë, jo unë. Auditimi i Brendshëm: kryetari duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe që Njësia e Auditorit të Brendshëm të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas Rregullores për themelimin e saj, e që njëkohësisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme. Auditori po thotë nuk janë ndërmarrë veprime, nuk ka filluar zbatimi. Pra, në bazë të kësaj përmbledhjeje të rekomandimeve të vitit paraprak, të cilën unë e lexova para jush, të nderuar asambleistë, ekzekutiv dhe qytetarë të nderuar të Dragashit, shihet se, prej gjetjeve të vitit 2023 vetëm dy janë zbatuar nga ana e ekzekutivit dhe

tri ende nuk kanë filluar. Kështu po thotë Auditori, besoj që janë institucion kredibil dhe kanë njohuri ata, nuk besoj që mujm na me qenë kundër tyre, në bazë të kësaj që ata na kanë paraqit neve këtu në këtë tabelë dhe në këtë material. Besoj që drejtori apo kryetari do ta marrë fjalën dhe do të japin pak shpjegim. Ju faleminderit!

Munir Jonuzi: E nderuara kryesuese, i nderuar kryetar, të nderuar delegatë, anëtarë të ekzekutivit, media të nderuara dhe të gjithë të pranishëm. Duke lexuar këtë raport të auditorit, nuk mund të mos krijoj përshtypjen se kemi të bëjmë me një lloj diagnoze. Dhe jo vetëm diagnozë e komunës sonë, apo e pushtetit tonë, por edhe e shtetit dhe shoqërisë sonë. Marrim një raport të auditorit që, sipas praktikës së zakonshme, zakonisht vlerësohet si pozitiv, me disa lëshime. Na japin një raport të tillë për shqyrtim, ne përçahemi për të, disa thonë se është raport i mirë, disa thonë se nuk është real, se as auditorët nuk i kanë përfshirë të gjitha, nuk i kanë parë rastet nga të gjitha këndet. Por ajo që është me rëndësi është se nuk ka pasoja, nuk ka përgjegjësi ndaj atyre që i kanë bërë këto gabime. Natyrisht, ata kurrë nuk do të përgjigjen, nuk do të mbajnë përgjegjësi për lëshimet e tyre. E pse mendoni se nuk do të përgjigjen? Sepse ky sistem dhe ky pushtet reduktohet vetëm në konstatime. Ne konstatojmë probleme të caktuara. Ne konstatojmë që ekziston një problem. E identifikojmë, e shënojmë në procesverbal dhe e lëmë aty. Nuk ka vazhdim, nuk ka zgjidhje, nuk ka përgjegjësi. Vetëm diagnozë, por pa terapi. E njëjta gjë edhe me këtë raport. Problemet janë identifikuar. Masat janë rekomanduar. Plani i veprimtimit është i gatshëm. E kemi në pikën e ardhshme të rendit të ditës. Por nuk ka asnjë sanksion. Këto janë, natyrisht, gabime të qëllimshme që i ka vërejtur auditori. Mirëpo, edhe nëse supozojmë që këto gabime janë nga padija, kjo nuk i shpëton nga përgjegjësia personat që i kanë bërë. Sepse fakti që nuk diçka nuk do të thotë që nuk je përgjegjës. Është njësoj si të ngasësh veturë, të të ndalojë polici, të mos e kesh vërejtur ndonjë shenjë – me siguri që do të të dënojë, pavarësisht që ke bërë diçka pa vetëdije. Tek ne, të gjitha këto raporte, të gjitha këto rekomandime përfundojnë me "është rregulluar", ose "do të rregullohet", ose "do të jetë më mirë herën tjetër". Po çfarë mendoni, a do të jetë më mirë herën tjetër? Sigurisht që jo. Sepse këto nuk janë gabime që po ndodhin tani për herë të parë, e nuk kanë ndodhur më parë. Vetëm do të përkeqësohet situata. Pastaj, duke lexuar me kujdes këtë raport, nuk mund të mos shtroj një pyetje retorike: A është e mundur që në këtë komunë të ndodhë ndonjë shkelje apo parregullsi – pa përfshirjen apo ndërhyrjen në një mënyrë apo tjetër të drejtorit të urbanizmit dhe drejtorit të shëndetësisë? A është e mundur që asnjë parregullsi të mos ndodhë pa ta? Le ta shohim çfarë ka gjetur auditori si gabime: Vonesa në zbatimin e kontratës dhe moszbatimi

i gjobave. Në këtë raport thuhet se kontrata me një kompani që kishte për detyrë të furnizojë barnat dhe materialin stomatologjik mjekësor, ka pasur afat prej 30 ditësh për të realizuar furnizimin. Duke marrë parasysh që kontrata është nënshkruar më 4 prill 2024, afati përfundimtar ka qenë diku më 3 apo 4 maj 2024 për ta kryer këtë furnizim. Mirëpo, ajo kompani, imagjinoni, i ka furnizuar barnat më 1 tetor. Nuk është vonuar një apo dy ditë – është vonuar 150 ditë. Pothuajse 150 ditë, apo pesë muaj. Drejtori i Shëndetësisë, si mbikëqyrësi kryesor i menaxherit të prokurimit të këtij projekti, pavarësisht kësaj vonese nuk ka ndërmarrë asnjë masë apo gjobë ndaj kësaj kompanie. Kontrata ishte e qartë – nëse kompania nuk e furnizon materialin brenda afatit prej 30 ditësh, atëherë komuna si porositëse ka të drejtë të vendosë gjobë prej 0.25% për çdo ditë vonesë, ose 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës. Moszbatimi i këtyre gjobave ka shkaktuar dëm të drejtpërdrejtë në buxhetin e qytetarëve dhe të komunës sonë në vlerë prej 1100 deri në 4000 euro, në varësi të përlogaritjes sipas kontratës që ishte nënshkruar nga shefi i prokurimit publik në atë kohë. Pra, 150 herë 0.25% është rreth 4000 euro. Komuna është dëmtuar për 4000 euro – maksimumi, ose 1100 euro minimumi. Cili ishte përgjigjja e drejtuesve të entitetit? Përgjigjja ishte: është dakorduar. Çfarë mendoni? A do të ndodhë kjo përsëri? Sigurisht që po – dhe prapë do të thonë "është dakorduar". Sepse kjo ndodh vazhdimisht. Nuk është hera e parë. Asnjë operator ekonomik nuk është ndëshkuar për mospërmbushje të kontratës në kohë. Asnjë operator nuk është ndëshkuar për punë të dobët. Asnjë operator ekonomik në këtë komunë nuk është futur në listën e zezë. Kujtojeni rastin e Brodit – çatia që nuk u rregullua sepse kompania nuk donte ta përfundonte projektin. Mua me të vërtetë më habit se si auditorët nuk e kanë vërejtur këtë dukuri në komunën tonë deri më tani. Tjetra: klasifikim i gabuar i të hyrave si projekt tjetër i ri. Në faqen 8 shkruan se nga kategoria mallra dhe shërbime janë paguar 22,000 euro për punë ndërtimore. Dje mora përgjigje nga z. kryetar i komunës se këto mjete janë shpenzuar për rehabilitimin e dëmeve nga përmytjet e vitit të kaluar. Këtë kritikë negative mund ta shmangim. Përveç asaj që keni përfshirë në pikën e tretë të rendit të ditës, këtë do të mund ta shmangnim edhe duke përfshirë në buxhet një zë të veçantë për drejtoratin e shërbimeve publike në raste të fatkeqësive natyrore. Në këtë mënyrë, kjo shumë do të ishte nga të hyrat vetanake, dhe nëse nuk ndodh ndonjë fatkeqësi dhe nuk shpenzohet kjo shumë, atëherë mund ta bartim nga viti në vit. Në fund, kemi edhe 34,000 euro nga kategoria e investimeve kapitale që janë shpenzuar për shpërblime jubilarë. Dje e pyeta z. kryetar për këtë zë dhe ai më tha se sqarimi shtesë do të jepet sot në Kuvend. Sepse, për të qenë i sinqertë,

më duket e çuditshme si disa i marrin shpërblimet jubilarë, e disa jo. Pse bëhet kjo diskriminim dhe cilat janë kriteret që disa i përfitojnë e disa jo këto shpërblime jubilarë?

Uran Halimi: Të nderum delegatë dhe ju të gjithë të pranishëm! Meqenëse po flasim për Raportin e Auditorit, ne si LVV patjetër që duhet të reagojmë, meqenëse janë gjetur gjashtë shkelje kryesore në këtë raport, ku tri prej tyre janë shkelje të përsëritura, që ndërlidhen me mospërputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret për financat publike, prokurim, menaxhim të pasurisë dhe auditim të brendshëm, mungesë ndëshkimesh për vonesa kontraktuale, keqklasifikime buxhetore, pagesa me vonesë dhe humbje nga mosinkasimi i borxheve. Çka nënkuptojmë përmes gjetjeve të Auditorit të Jashtëm në Komunën e Sharrit, që kjo qeverisje tashmë nuk është e aftë të bëjë dallimin në mes të shpenzimeve kapitale dhe kategorisë për Mallra dhe Shërbime. Kjo është një gjë elementare për një qeverisje lokale. Ja edhe argumentet: në tetë raste të pagesave të ekzekutuara nga Thesari për vendime përmbarimore, me vlerë totale prej 67,110 euro, Komuna ka regjistruar shpenzime në kategori të gabuara ekonomike, ku 9,900 euro janë paguar nga kategoria Mallra dhe Shërbime në dy raste. I kemi 1210 euro nga komunalitetë – kjo është me një rast – dhe i kemi 34000 euro nga investimet kapitale, këto qëndrojnë në katër raste. Ndërsa, këto shpenzime kanë qenë për paga jubilarë dhe shujta, që duhet të klasifikohen si shpenzime për paga dhe mëditje. Gjithashtu, janë paguar edhe 22000 euro nga mallra dhe shërbime për punë ndërtimore, që në natyrë llogariten si investime kapitale. Mungesa e Auditorit të Brendshëm, edhe kjo ka të bëjë me mungesë të kontrollit të brendshëm për të cilën unë besoj se shumë komuna kanë qenë të interesuara të jetë kështu. Në fakt, edhe Komuna jonë ka qenë e interesuar që të ketë mungesë të kontrollit të brendshëm. Në këtë pikë, njëra prej tyre është moskompletimi i Njësies së Auditimit të Brendshëm, gjetja në Rregulloren Nr.01/2019 për Themelimin dhe Zbatimin e Funksionit të Auditimit të Brendshëm në subjektin e sektorit publik, ku në Nenin 5.1.1 përcakton se çdo subjekt i sektorit publik me buxhet mbi 7 milionë euro, duhet të ketë së paku tre auditorë të brendshëm. Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Dragashit përbëhet vetëm nga një auditor, dhe në këtë rast Komuna nuk ka ndërmarrë veprime për plotësimin e kësaj kërkesë. Domethënë, Komuna jonë nuk ka dashtë apo nuk ka pas interesim që të themelojë Auditimin e Brendshëm, i cili duhet të përbëhet nga tre anëtarë më së paku. Për shkelje të tjera folën edhe kolegët tanë. Unë po besoj që edhe kryetari e ka tashmë të njohur për ato parregullsitë. Mirëpo, gjetjet e përsëritura mua më japin me kuptue që këto janë në interes të kësaj qeverisjeje lokale. Përveç gjetjeve të reja, ekzistojnë gjetjet

e përsëritura, të cilat ne si Komunë duhet t'i eliminojmë apo t'i mënjanojmë ato. Faleminderit shumë!

Jetmir Ajdini: Përshëndetje për të gjithë! Deshta vetëm ta plotësoj Uranin te gjetjet e Auditorit. Rasti i dytë që ka bo gjetje Auditori është vonesa në realizim të kontratës dhe moszbatim i ndëshkimeve. Është rasti për materialin shpenzues mjekësor për QKMF-në dhe materialin stomatologjik. Urdhërblerja është bërë me datën 4 prill, ndërsa furnizimi është bërë me datën 1 tetor. Domethënë, pesë muaj të plotë Komuna nuk ka qenë në gjendje me e gjet një operator ekonomik i cili bën furnizim të rregullt të QKMF-së me materiale shpenzuese. Edhe pse kjo vonesë, Komuna nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ndëshkimor ndaj operatorit ekonomik, që është shkelje, se ka të drejtë Komuna të marrë veprime ndëshkimore ndaj operatorit ekonomik i cili nuk i plotëson kushtet. Kjo përkthehet me mungesë të barnave dhe materialit shpenzues për qytetarët tanë. Pesë muaj të plotë operatori ekonomik nuk ka qenë në gjendje ta bëjë furnizimin e QKMF-së dhe Komuna jonë nuk ka qenë në gjendje të marrë masa ndëshkimore ndaj këtij operatori ekonomik. Për gjetjet tjera u fol nga kolegët paraparakë. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Përshëndetje për të gjithë! Realisht, unë kam menduar që në këtë gjashtëmuor mos me dalë hiç me ju dhënë përgjigje, sepse përgjigjen e keni marrë te Raporti i Auditorit, për të vetmin qëllim se kemi fillue me fushatën zgjedhore dhe e drejtë e juaja është që të bëni pak politikë. Për faktin se këto rezultate janë të këtij Kuvendi që ju i keni marrë vendimet dhe kjo qeverisje i ka ekzekutuar, dhe kjo e arritur pozitive, që duhet të mburreni ju edhe ta falënderoni, është punë kolektive e juaja, në bashkëpunim me neve ekzekutvin. Vërejtjet e juaja na kanë shti me ardhë deri në këtë që, veç ta lexoni opinionin e Auditorit se çfarë thotë, është një punë kolektive që, qato vendime ju si Kuvend që i keni marrë, ne kemi qenë në gjendje t'i ekzekutojmë. Bile, ndiejmë kënaqësi se ata të cilët na kanë kritikuar, na kanë dhënë një motiv shtesë që të angazhohemi dhe të kemi rezultate pozitive. Pozitive është së katër vite e vetmja Komunë në Kosovë është që ka fitue Grantin e Performancës. Dhe, po mos ta kalojke auditimin e jashtëm, nuk do të ishte pjesë e Grantit. Është e vetmja komunë – mbane në mend – katër vjet rresht e ka fituar Grantin e Performancës. Është punë kolektive. Nuk deshta me ju dhënë përgjigje pyetjeve tuaja. Keni të drejtë të bëni pyetje, keni të drejtë edhe pak të kritikoni, keni të drejtë edhe ta përdorni tash foltoren edhe për fushatë. Por unë megjithatë ju jam mirënjohës. Në aspektin ekonomik, nuk ka raport më të mirë, pyetni kolegët tuaj ekonomistë. Vetëm mos hi në profesion të huaj, se nuk të hi në pprofesion tëndin. Po të tregoj që ky raport me qenë negativ, ti nuk mundesh me qenë pjesë e

Grantit. Dhe këtë nuk e vlerëson ti, por e vlerësojnë ekspertë të jashtëm 320 lëndë janë audituar, gjashtë muaj është punuar për me ardhë qeky auditimi. Sa u përket gjashtë gjetjeve, po fillojmë me rend: Për pasurinë, kemi folë që nën 1000 euro, pasuria regjistrohet në ePlatformë. Dhe, ka pas probleme që për 14 vjet nuk është regjistruar, ne kemi filluar tash. E kemi diskutuar në secilën seancë, për herë të parë të dhënat në vitin 2023, nën 1000 euro, i kemi shti, për arsim dhe shëndetësi. Për 14 vjet që nuk është bo zhvlerësimi i atyre mjeteve në pasqyra financiare na paraqet jobarazim. Dhe kjo neve na është pranuar në mënyrë fizike, dokumentet të cilat i kemi çuar, dhe prej 2023 e këndej ne jemi në gjendje të rregullt. E kemi diskutuar këtë çështje. Pasuritë mbi 1000 euro, të investimeve kapitale, Qendrën për Punësim e kemi bo pronë tonën. Ka qenë e paregjistruar, e kemi regjistruar. Pra, nuk kemi kurrfarë problemi. Për pasurinë nën 1000 euro, kemi krijuar edhe dy nëndepoistë, një në arsim dhe një në shëndetësi. Tash të gjitha pranimet bëhet nga nëndepoistët. Kemi caktuar zyrtarin e pasurisë i cili tash pret që në aspektin teknik të përgatitet, edhe qeveria ta ketë platformën në rregull, edhe në sistem t'i shtijë të gjitha të dhënat dhe të rregullohet kjo çështje që nuk është problem vetëm për Komunën tonë, sepse është problem teknik. Por, jo më problem ekonomik, për arsye se e bëjmë regjistrimin për çdo vit në mënyrë fizike, dhe në qoftë se nuk je i bindur, unë e thirri zyrtarin, t'i bjer folderët e t'i vë në tavolinë. Për auditimin e brendshëm, ne kemi qef me i punësue edhe dy. Kryetarit sot me ia lëshue kodin ata, t'i punëson edhe dy. Është obligim ligjor, por nuk kemi kod për punësim. Në Ministrinë e Financave duhet me e marrë një kod për me punësue. Doktor, nuk është realiteti në bazë të logjikës tënde. Dëgjo, pastaj del e diskuto! E gjetura edhe vërejtja për auditorë të brendshëm që të kompletohet Njësia e Auditimit nuk është vërejtje për Komunën. Në qoftë se e kuptosh ti drejt procedurat e auditimit kombëtar. Duhet Ministria me na lëshue kodin që ne me i punësue. Këtu është problemi, se nuk jemi më të fuqishëm. Në qoftë se ke një ekonomist, merre dhe shko shikoi procedurat pse nuk janë këto. Sa u përket borxheve, në 2022 i kemi pas 2 milionë e 900 e diçka mijë euro, tash kemi 1 milion e 600 mijë edhe kryesisht i kemi të tatimit në pronë. Ju e dini se kemi pas mbi 200 mijë euro inkasimeve të borxheve që në vitin e parë 2022 dhe në 2023, pikërisht me vendimin e këtij Kuvendi. Dhe tash merrne qyrne, lexojeni situatën qysh ka qenë edhe qysh është. Dhe, a e keni paraysh se borxhet pasive të cilat mbesin, çdo vit duhet me e rrit vlerën, përkundrazi, ne prej se kemi ardhë në pushtet nuk e kemi rrit vlerën, por kemi rënie të borxhit. Ne e kemi gjet Komunën me 10 kontrata, i kemi 71 kontrata për shfrytëzimin e pasurisë. Del gjeje një biznes i cili ankohet për kontratat të cilat i kemi bo. Nuk ka vërejtje askush. Prandaj, ju delegatët duhet me qenë të informuar shumë drejt

edhe me e përcjellë punën prej fillimit e deri më tash çka kemi bo. Jemi komuna që kemi bo uljen më të madhe të borxhit dhe kemi një borxh shumë që është e pamundshme në këto rrethana të ndalet, për shkak të vonesave dhe procedurave. Tash për momentin kemi me sistemin për pagesat e tatimit në pronë. Janë probleme teknike që nuk i ka fajet stafi. Edhe na ndodhin, ka ngarkesa, nuk mund t'ia nxjerrë faturën dhe këto shkaktojnë vështirësi. Por, përkundër të gjitha këtyre vështirësive, ne kemi raportin gjashtëmuor. Kemi të hyra plus, kemi inkasim – në raport me vitin e kaluar – më shumë të hyra. Bëjeni njëfarë bilanci, krahasimi. Jemi në progres e sipër. Kjo tregon se edhe borxhet i kemi zvogëluar. Mosfurnizimi me barna, kjo ka mund të na kushtojë shumë shtrenjtë, sikur mos me pas qenë të vetëdijshëm se ka një kontratë qeveria për barna të veçanta të cilat nuk mundet kompania me marrë edhe me pru derisa nuk hyjnë këtu. Ka pru një sasi të barnave që kanë qenë, një pjesë tjetër e ka pru me vonesë për shkak të importimit të vonshëm atje. Dhe, kjo mospërputhje që ka ndodhë me importet, ka ndikuar edhe në Komunë. Ne po kemi vështirësi edhe me një toner për shkak të kontratave të cilat i ka nënshkrue qeveria. Një toner që kushton 13 euro. Po kemi problem, sepse nuk po furnizojnë kompanitë në kohë, ose kur duhet, sepse kryesori është Qeveria për këto. Dhe, për disa barna nuk kanë kompetencë kompanitë, është njëfarë zinxhiri, unë mjek nuk jam dhe nuk e di a janë ato barna që vijnë përmes Qeverisë barna esenciale apo jo. Por në auditim, data e importit dhe vonesa këtu nuk ka, se në momentin kur është importue këtu, ka mbërri në Kosovë, mas dy ditëve ka mbërri edhe në Dragash. Kur nuk ka pas në Kosovë, nuk ka pas ku me u furnizue operatori, se nuk ka të drejtën e importimit të barnave asnjë operator, përveç ata që e kanë të drejtën prej qeverisë. Kjo ka ndikue që neve nuk na është quajti si e gjetur, sepse mund të ketë pasoja sanksionuese. Dhe ne nuk jemi sanksionue, se është auditue ajo lëndë prej Prishtinës deri këtu. Në qoftë se doni për inat – hajde e çojmë dikënd me thashetheme në burg – ajo është çështje tjetër. Veç, procedurat ligjore e kan dëshmuar se çdo gjë ka qenë në rregull. Për këtë arsye raporti i Auditorit e thotë kështu. Sa u përket klasifikimit të pasaktë të shpenzimeve, ne kemi biseduar këtu se përmbaruesi nuk pyet. Kemi thënë shumë qart, na ka ndodhë një send që nuk ka ndodhë, na kanë marrë edhe prej komunaleve, vetëm e vetëm me i pague. Por ky nuk ka qenë keqklasifikim. Për paga dhe mëditje Auditori na ka thënë se çdo gjë është në rregull, sepse është harxhue shuma e pagave dhe e mëditjeve, ju e dini që vitin e kaluar kemi luftuar dy muajt e fundit, kemi bërë 100 përpjekjet për me i marrë rrogat zyrtarët, se kemi mund me mbet komplet stafi pa rroga. Por çka ka ndodhë? Na i ka marrë në Mallra dhe Shërbime, na ka marrë në Investime Kapitale, na ka marrë në Subvencione, ka shkue na ka marrë edhe në Komunale. U dashtë vetëm

prej pagave dhe mëditjeve me i marrë. Por, po ju tregoj me shumë përgjegjësi dhe kompetencë, është zyrtari i Buxhetit të Kosovës – ne kemi planifikuar me kryetarin 300 mijë euro mjete në fondin për paga dhe mëditje – a e dini cili ka qenë urdhri? Po nuk i shpërndave këto në investime kapitale, t’i marr krejta. Sepse ne e kemi ditur për afërsisht që ka m’u atakue buxheti prej përmbaruesit. Dhe, përmbaruesi nuk të pyet ty ku po t’i merr paratë. Disa projekte të investimeve kapitale kanë qenë në zhvillim e sipër, kanë qenë paratë pa zotuar, se në momentin kur kryen punimet kërkohet që atij muji të planifikojmë me e bo pagesën, dhe i themi zyrtarit të zotimeve që t’i zotojë këto mjete, sepse duhet me ia bo filan firmës pagesën. E njofton Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria e Urbanizmit. Ato mjete të cilat zihen pa u zotue, t’i merr. Dhe na ka marrë, në ka marrë në ujë, na ka marrë në projekte shumë më të rëndësishme dhe kjo ka ndodhë. Por kjo nuk ka ndodhë më vullnetin e zyrtarëve. Nuk kemi mund ne të kontraktojmë një kompani – projekt dyvjeçar – në qoftë se nuk kemi pas mjete. I kemi pas mjetet. Kush i ka marrë? I ka marrë përmbaruesi. Atëherë, ne mbi ligjin nuk jemi. Kjo procedurë vazhdon kështu. Kur janë marrë nga të gjitha kategoritë buxhetore, Auditori ka thënë se kjo është keqplanifikim. A në fakt nuk ka pas të bëjë me keqplanifikim. Sepse ne për paga dhe mëditje e kemi pas të harxhuar fondin, nuk ka pas çka me marrë. E fundit që po dua t’jua them, sipas opinionit të Auditorit – po jua lexoj atë që e thotë Auditori dhe ai që është profesional. Qe çka thotë: “Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Dragashit prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë të të gjitha aspekteve materiale, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik.” Opinioni i Auditorit Kombëtar, mbaje në mend, se këtë e bën Auditori Kombëtar, pasi të bëhet krejt auditimi. Pra, kështu opinioni nuk e di që mundet me dhënë dikush tjetër më mirë. Faturat me kohë: Pas 14 dhjetorit, kur është mbyllë sistemi i pagesave, ka mbërri fatura për pagesë dhe është regjistruar si borxh dhe është paguar vitin tjetër. Shumë e thjeshtë kjo punë është.

Bexhet Xheladini: Të nderuar të pranishëm, prej se jam unë kryetar i Komunës, të gjitha raportet e Auditorit kanë ardhë eksellent. A e dish çka do me thënë ‘eksellent’? Shkëlqyeshëm! Qëllimi i auditimit është me i auditue pasqyrat financiare. Pasqyrat financiare të gjitha kanë qenë eksellent, shkëlqyeshëm, pa asnjë gjetje. Nëse Auditori kishte gjet parregullsi në pasqyrat financiare, atëherë ka vend edhe për ndjekje penale. Sa u përket rekomandimeve që i ka dhënë, ato janë rekomandime teknike. Nuk janë gjetje, nuk janë gabime. Rekomandime teknike është njësoj sikur me thënë duhet me shkue në Prishtinë, por mundish me shkue me autobus, mundesh me shkue me automjet, mundesh me shkue edhe në këmbë, po ti në Prishtinë duhet me shkue. Këto janë rekomandimet të

cilat na i ka pru Auditori i Jashtëm, edhe ne nuk do të thotë që nuk janë me vend, pra ne do t'i zbatojmë. Disa i kemi zbatue, disa janë në zbatim dhe disa do t'i zbatojmë deri në fund të vitit. Kështu që, edhe këto rekomandime që kanë ardhë, nuk janë të gjitha faji i Komunës. Për shembull, te rekomadimi numër 1 nuk është faji i Komunës, është faji i organeve qendrore sepse përmbaruesi edhe Ministria e Financave, në vend se me i marrë mjetet nga ku janë krijuar shpenzimet, nga pagat dhe mëditjet, i ka marrë mjetet nga Mallrat dhe Shërbimet, nga Investimet Kapitale, nga të Hyrat Vetanake, nga Subvencionet, bile kemi pas rast që i kanë marrë edhe prej bursave të studentëve. Neve para se me na i marrë mjetet, ata na çojnë një email edhe na pyesin ku me i marrë mjetet. Edhe ne i themi mjetet me i marrë prej atij pozicioni ku janë krijuar këto shpenzime – këto shpenzime të kontratës kolektive ata është dashtë me i marrë prej pagave dhe mëditjeve – edhe pavarësisht nga ajo, që ne je iu kemi thënë me i marrë prej këtij pozicioni, ata i kanë marrë nga pozicionet tjera. Pse? Sepse në fund të vitit, Qeveria e di që, mjetet që mbesin pa shpenzue nga pagat dhe mëditjet, nuk i mbesin më Komunës por i kthehen Qeverisë. Kështu që, këtu është e krejt poenta e kësaj, për atë ai nuk t'i merr në paga dhe mëditje por t'i merr tjetërkund. Te vonesat e pagesave, drejtori Qamili e tha, është fjala kur ka kompani të cilat e bien faturën në fund të vitit, kur mbyllet buxheti. Edhe tash këto faturat paguhen vitin e ardhshëm. Vitin e ardhshëm nuk lëshohet menjëherë buxheti në janar, lëshohet vonë, edhe munden me kalur mbi 30 ditë edhe ajo e merr epitetin e vonesës së pagesave. Këto vonesa nuk janë paguar me përmbarues. Gabim e ke kuptue! Me përmbarues janë paguar disa të tjera. Gjithashtu, gjetje tjetër teknike ka qenë t regjistrimi i pasurisë, e tha atë drejtor Qamili. Nuk është faji ynë pse ePasuria nuk po punon nga qendra. Mirëpo Auditorit nuk i intereson, ai e tregon gjetjen. Dhe, sa i përket grumbullimit të të hyrave, ne kemi rritje, kemi ngritje, por nuk munden asnjë qeveri të gjitha borxhet me i mbledhë, sidomos këto borxhet që janë të tatimit në pronë. Edhe rekomandimi i fundit është te auditori. Ju e thatë që nuk ka Auditor të Brendshëm. Ka Auditor të Brendshëm, po më vjen keq që s'po e dini. E keni qit edhe në Facebook, Komuna nuk ka Auditor të Brendshëm. Komuna ka Auditor të Brendshëm, por nuk ka të mjaftueshëm. Ne do ta zbatojmë rekomandimin për plotësimin e Auditorit të Brendshëm. Do të gjejmë forma dhe metoda qysh do ta kryejmë. Pasi që kjo po përsëritet qe disa herë. Qe tri vite përsëritet kjo. Ju duhet ta dini që, përveç se Komuna ka Auditor të Brendshëm, ka edhe Komitet të Auditimit, i cili i ndihmon Auditorit të Brendshëm edhe kryetarit të Komunës. Z.Muniri e ka bo një pyetje, shpërblimet jubilarë. Bëhet fjalë për pagesën e kontratës kolektive, dhe kur është bërë ajo pagesë, është klasifikuar në këtë kod, ku aty shkruan që janë

shpërblime jubilarë. Pra, nuk është shpërblye dikush që ka marrë ndonjë shpërblim për punën e kryer ose ndonjë shpërblim me ndonjë vendim të kryetarit, por janë mjetet të cilat u janë lëshuar punëtorëve të arsimit për pagat jubilarë, për kontratën kolektive. U përmendën disa shifra, pse është bërë pagesa e investimeve kapitale nga mallrat dhe shërbimet. Siç e dini, para një viti e më shumë, para 15 muajve, Komuna e Dragashit ka pas vërshime në disa fshatra. Aty janë bërë dëme edhe në infrastrukturë publike, edhe në ekonomi familjare, bujqësi, blegtori etj. Komuna i ka krye urgjentisht të gjitha procedurat, në mënyrë që qeveria ta bëjë pagesën e dëmeve që janë bërë në infrastrukturë. Mirëpo, ne kemi prit dy muaj, qeveria nuk na ka ndihmë në këtë drejtim, atëherë ne jemi detyruar që këto që quhen si investime kapitale t'i bëjmë me Mallra dhe Shërbime. Mirëpo, Auditori këtë nuk e pranon dhe e ka klasifikue si gabim. Dua ta shfrytëzoj këtë foltore që t'i drejtohem qeverisë me një lutje, që kam shumë trysni prej qytetarëve të cilët kanë pësue dëme të konsiderueshme nga vërshimet, kam kërkesa shumë të mëdha edhe pyetje se çka u bë me pagesën e dëmeve nga vërshimet. Unë dua ta lus Qeverinë e Kosovës që është në detyrë, që të fillojë sa më shpejt pagesën e këtyre dëmeve, sepse të gjithë dokumentacionin komplet e ka në Ministri të Financave. Komisioni komunal i ka krye të gjitha punët e veta, Komisioni Qendror për Vlerësimin e Dëmeve i ka krye punët e veta, materialin e ka çue në Ministri të Financave për ekzekutim. Ky material pret vetëm nënshkrimin e zv/ministrit apo ministrit të Financave dhe pastaj qytetarët t'i marrin këto mjete. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Kërkoj falje! Dëgjoni! 15,747 euro janë vonesa në pagesë për kontratën kolektive. Borxhi bazë ka qenë 29,363 euro në vitin 2016, 2015 apo kur është nënshkruar kontrata kolektive. Dhe Auditori e quan vonesa në pagesë. Për shkak të atyre vonesave janë paguar qato 15,747 euro, por janë të kontratës kolektive. Kjo qeveri nuk ka të bëjë me këtë pagesë. Këto janë që i merr përmbaruesi, gjykata dhe tjerat. Ne i kemi përmbush komplet pagesat e kontratës kolektive dhe jemi duke i përmbush.

Jetmir Ajdini: Atëherë, te vonesa në pagesën e obligimeve, Auditori të ka gjet: Obligime të papaguara për vitin 2024 në total arrijnë shumën prej 97,751 eurove. Obligime të papaguara po të thotë. T'i ka gjet Auditori, 97 mijë euro. Këtë ta bëra pyetje. Çka nëse këto fatura lypin secila me u pague me përmbarues, për shkak të vonesës që nuk e keni bo ju pagesën. Atëherë, ne e paguajmë edhe shumën e përmbaruesit, edhe krejt këto. Obligime shtesë për Komunën. Këtë ta bëra pyetje.

Bexhet Xheladini: Qato mjetet që po i përmend doktori, ato janë paguar. Ka fatura të cilat vijjnë në fund të vitit, në dhjetor, edhe nuk ka mundësi me u pague sepse buxheti mbyllet në fund të

dhjetorit. Këto pastaj barten si borxhe të vitit 2024 për me u pague në vitin 2025. Ato mjete janë paguar në formë të rregullt. Po ato nuk kanë qenë të paguara, sepse fatura ka qenë e vitit 2024, dhjetor 2024. Edhe tash, ajo nuk ka mund me u pague, po u pague në shkurt të vitit 2025. Pa përmbarues. Ligji e parasheh, edhe nëse ke vonesa në pagesa, ti duhet me i planifikue që ato pagesa t'i bëjsh vitin e ardhshëm. Ta njeh ligji atë.

Uran Halimi: Gjithçka që kanë thënë parafolësit e mi – drejtori për Ekonomi, pastaj edhe kryetari – unë kam mbaj shënime. Në fillim drejtori për Ekonomi tha që ne po i zbatojmë vendimet që ju i keni marrë. Deshti me e nxjerrë veten kështu si të pafajshëm, po ne nuk marrim vendime për moszbatim të pagesave, o drejtor. Mandej nuk marrim vendime për mosfurnizim me barna esenciale. Ju i merrni këto vendime. Tjetra është mosinkasimi i borxheve. Mos e kemi marrë na atë vendim? Bile-bile, në shumicën e rasteve disa çmime i kemi rrit na që ju me marrë ma shumë pare edhe me inkasue ma shumë pare. Mandej, nuk kemi marrë vendim na që ju mos të keni zotësi për klasifikim të pagesave. Nuk është përgjegjësi e jona. Mandej, tjetra tha që disa pagesa bëhen përmes ePlatformës. Aty e di që e keni problem, te ePlatforma, se ju jeni të mësuar me qeveris me fatura që i shkruni me dorë. Po tash është viti 2025, i nderumi drejtor. Mandej, tjetra tha që nuk kemi edhe kode për punësime te Auditori i Brendshëm. Mungesë e kodeve! Unë e di saktë që këta, për me i gjet do kode, marrin atë klasën e ndajnë për gjysmë, edhe i ndajnë nxënësit, nja dhjetë nxënës i ndajnë, pesë andej e pesë kënde, edhe e punësojnë edhe një njeri të tyre, të devotshëm, të ngushëm ose ku e di çka. Tjetra tha që kemi probleme edhe me tonera të printerave. Normal që keni probleme me tonera të printerëve, se ti aferën e printerëve e ke në prokurori e në hetuesi, e dijsht ti shumë mirë këtë punën. Tjetra tha doni me e çue dikënd në burg me thashetheme. Kush shkon bre në burg prej thashethemeve, mos iu tut thashethemeve. Mandej tha që përmbaruesi na i ka marrë do pare, tha bile kemi rrezikue me mbet pa rroga edhe pa mëditje. Keni rrezikue, se te Paga dhe Mëditje ju e keni harxhue maksimalisht buxhetin duke i shpërblye dostat, të dielave duke dalë në bjeshkë atje, duke i pague me mëditje. Mu po më vjen mirë, znj.kryesuese, që ti vazhdimisht je duke i ndihmue korrupsionit edhe hajnisë. Jeni duke u mundue vazhdimisht me e dëmtue demokracinë, kur unë e goditi dikë për parregullsi. Zonja kryesuese ma ndalën fjalën, mirëpo unë jam këtu, fjalë nuk më ndalet.

Arijeta Skeraj: Dëgjo, mos del para opinionit që po ta ndali fjalën! Ma herët e more, ke mund dhjetë minuta me folë. Tash për replikë je thirrë, dy minuta. Ti ke thënë mbaju Rregullores, kjo është Rregullorja, në këtë foltore ke qenë ti edhe ti na i ke thënë këto. Sa për fjalën, kurr nuk ta

kam ndalë, në pikën eventuale mundesh me ia thënë të gjitha. Po në pikën eventuale zakonisht ti nuk rrih. Të kisha lut me e ndëpre!

Agron Gashi: Atëherë, ju përshëndes të pranishëm! Unë vetëm pak dola të sqaroj lidhur me raportet e auditimit, të kaluarës dhe ditët e sotit të cilat kanë ardhur. E kaluara ka një raport të tmerrshëm. Po fillojmë prej investimeve kapitale, të cilat qeverisja paraprake gjatë asaj kohe ka arritur vetëm 50%-60% t'i implementojë investimet kapitale. Sot, Raporti i Auditimit, për shkak të vonesave dhe tenderimit në Zyrën e Prokurimit që, prej muajit qershor kanë filluar tenderimet dhe për shkak të vonesës nuk ka mundur të i kryejë investimet kapitale, dhe se kanë mbetur mjete mjaft. Pastaj janë gjetur lëshime në rrugët e Gorës për të cilat thotë raporti që ka qenë në mënyrë fizike dhe ka parë gjendjen aktuale në disa rrugë të Gorës. Thotë kështu: Mbi 70 mijë euro janë paguar para nga Komuna, janë ekzekutuar, por gjendja praktike, kur kanë dalur në terren për të parë betonimet dhe rrugën, aty është konstatuar se fare nuk janë kryer punimet, por ajo qeverisje i ka ekzekutuar paratë. Tjetër çka thotë: Kemi OSHP-në e cila thotë, OSHP-ja e cila mbajti zvarrë për dhjetë vite këtë Komunë, thotë se për shkak të tenderimeve jo të rregullta dhe lëshimeve të cilat kanë punuar me qeverisje të dobët, ka mbetur për dhjetë vite zvarrë çështja e ujit në këtë Komunë. Gjë që jeni duke e parë se si është ndryshimi tash, si e shfuqizoi dhe si mundi kryetari ta shfuqizojë në nivel qendror dhe t'i ekzekutojë këto punime që janë në përfundim e sipër, dhe një 5% të punimeve ka mbetur dhe se tani uji do të lëshohet për 15 fshatra. Tjetër, kemi faturat nën 100 euro. Raporti i Auditorit thotë se nën 100 euro thotë se janë lëshuar pagesa të panumërta. Përmbaruesi, 2017, 2021, sidomos është kontrata kolektive, shujtat e mësimdhënësve të cilët e kanë dëmtuar mbi 2 milionë qeverisjen pasardhëse. Përmbaruesi i ka marrë mjetet dhe e keni dëmtue qeverisjen pasuese. Mos harro, kjo Komunë është ndër më të varfërat në Republikën e Kosovës. Keni dëmtuar, 14 vjet, 14 milionë suficit i keni kthyer në nivel qendror, për shkak se nuk keni mundur t'i ekzekutoni. Mos harroni, kjo qeverisje tani që e kemi ka arritur të marrë Grantin Qeveritar. Kjo qeverisje tani që është dhe këto raporte që kanë ardhë janë më tepër se një mrekulli në krahasim me të kaluarën. Opinioni duhet ta dijë dhe të bëjë krahasimin – ndash metaforik, ndash atë bazik – të punës, se dallimet janë qenësore dhe ky kryetar ka shënuar progres të madh. Faleminderit shumë!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Ju kisha lut të gjithë asambleistëve që, kur të dalin për atë pikë, për atë pikë le të flasin. Uran, sidomos ty po të them, po më thuesh ndalja se replikë. Agroni nuk e ka marrë sot fjalën. Ti bile ke qenë kryesues këtu edhe e dish që asambleisti që nuk e merr fjalën ka

të drejtë dhjetë minuta. Prej atje po thuosh që replikën e kreu, kur ai për herë të parë ka dalë. Çfarë replike është këtu, Uran? Ti vetë ke qenë kryesues. Ai për herë të parë është, ai e ka të drejtën. Të lutem, doktor Jetmir, çka ke sot që e ke përça këtë Asamble. Të lutem, vetëm kur ta jap fjalën.

Nedžmidin Sejdilar: Faleminderit. Zonja Kryesuese, do të ju lutesha që në të ardhmen të mos më thërrisni Nedžo, sepse unë jam zoti Sejdilar në këtë kuvend. Silluni me respekt dhe mos e cenoni dinjitetin tim në këtë kuvend. Së dyti, zonja Kryesuese, unë jam paraqitur për fjalë para Samidin Xheladinit, edhe pse Samidin Xheladini u paraqit para zotit Gashi. Ju, nga ajo ulëse, duhet të shihni se kush kur është paraqitur për fjalë dhe sipas kohës ta jepni fjalën. Unë vendosi vetë se kur dua të paraqitem për fjalë. Mund të pres deri në fund dhe atëherë të paraqitem për fjalë dhe ta shfrytëzoj kohën time. Gjithashtu, unë në këtë foltore, në çdo pikë të rendit të ditës mund të vij, të rri 10 minuta dhe të mos them asnjë fjalë. Ju duhet ta respektoni kohën time, ashtu siç e respektoj unë kohën tuaj. Unë tani do të qëndroj këtu, në shenjë proteste dhe revolte, do të hesht dhe nuk do të them asnjë fjalë – dhe ju duhet ta respektoni këtë. Nuk mund të ma mohoni këtë të drejtë. Më vonë do të vazhdoj për pikën e zotit Xheladini – ju premtoj, do ta bëj. Unë jam shumë i talentuar për protesta, mos më provokoni tani. Pra, zonja Kryesuese, sa i përket raportit të auditorit, mua më interesojnë tri çështje. Po filloj me radhë: E para, më intereson – a është ndëshkuar Qendra e Mjekësisë Familjare për vonesën e barnave? Zoti Kryetar, po ju drejtohem juve. Nëse do të delegoni ndonjë nga bashkëpunëtorët tuaj, kjo fare nuk më intereson. Më intereson vetëm a është ndëshkuar Qendra e Mjekësisë Familjare për shkak të vonesës së barnave. Këtë e ka gjetur auditori në raport. E dyta, më interesojnë ato shpërblimet jubilarë. Edhe pse dje në Komitetin për Politikë dhe Financa isha i pranishëm, ju thatë: “Mund t’ua sjell edhe listën.” A e keni sjellë atë listë? Që të shohim saktësisht se kujt i janë dhënë ato shpërblime. Thatë se janë sipas kontratave kolektive, por mua më intereson saktësisht: ku kanë shkuar ato para, në cilat adresa janë dërguar për shpërblimet jubilarë? E treta, ju nga pushteti ekzekutiv – më intereson me të vërtetë: si mund të na bindni neve në Kuvend që ju keni të drejtë, kur nuk e keni bindur as auditorin? Auditori ua ka gjetur këto gabime, jo ne. Ne kemi raporte të auditorit ku auditori i referohet gabimeve, gabimeve procedurale dhe gjërave të tjera. Si mund të më bindni mua – pse nuk e bindët auditorin? Ju keni pasur më shumë kohë. Faleminderit.

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm, ju përsëndes të gjithëve! Unë nuk dashta me diskutue, siçdo herë, po due me rrit në heshtje, me i dëgjue të tjerët. Por, shumë herë po më shti e vërteta dhe e pavërteta me dalë edhe me diskutue këtu. Ndoshta i fundit duhet me folë, por po më

bjer hise bile me folë i pari, me i argumentue dëshmitë, faktet dhe ngjarjet. Ju duhet me u mburr, edhe ne edhe e gjithë Komuna e Dragashit duhet të mburret me një raport ekselent, fenomenal, edhe më të mirin të mundshëm ndoshta edhe në Kosovë. Raportet e të kaluarëve i di, që 16 vite i di. Dhe, raportet të cilat ju i keni pas reastin t’i shihni, raport të vitit të kaluar, në vitin e parë të mandatit që e kemi marrë, e keni pas rastin ta shihni edhe ta lexoni ju vetë. Ne kemi pas mandat katërvjeçar dhe gjatë këtij mandati ne duhet ta japim kontributin maksimal për mirëqenien e qytetarëve. Dhe, jam shumë i lumtur, kur e kam pa raportin e auditimit. Po jua kallxoj veç një rast, e keni pas vitin e kaluar. Auditori e ka bo vërejtje, pse një gabim, a teknik a me qëllim, a pa qëllim, e dini mirë që numri i banorëve në Komunën e Dragashit ka qenë 1. Numri 1. Kërkush nuk e bën atë ndoshta me vetëdije, por ka ndodhë, për atë kemi humb mjete. 30-40 mijë euro. Vonesat prej 1 janarit regjistrohen te viti i ardhshëm, auditori e regjistron ashtu, se ashtu ligji e jep. Dhe po jua shpjegojnë shumë mirë. Unë po ju them një gjë, ta dini mirë. Ne duhet të mburremi, nuk është me rëndësi a fitojmë ne apo jo, ne duhet të mburremi të gjithë, edhe ne si asambleistë që jemi pjesë e këtij auditimit. Edhe duhet të jemi krenarë. Edhe të lavdërohem, se edhe puna jonë është, edhe e juaja, edhe e këtyre. Të gjithë kemi pjesë, edhe qytetarët kanë pjesë, që kjo qeveri e ka sjellë Komunën tonë në një shembull në Evropë. Edhe dijeni mirë, se nuk po i lexoni raportet e kalume, nuk po i lexoni raportet tjera, ndoshta nuk po dëgjoni çka po ndodh në Kosovë edhe në qendër. Lexojeni ju të VV-së Raportin e Auditimit për qeverinë qendrore, edhe e keni një pasqyrë shumë të mirë, edhe nuk keni nevojë këtu me dalë me sha, po lëvdata më të mëdha keni me ia bo qasaj qeverisë. Po ju kallxoj një gjë për Auditimin e Brendshëm. Kur ka qenë Salim Jonuzi para 12 viteve, unë kam qenë qaj që kam thënë: o kryetar, merri edhe dy auditorë se po na lejon ligji. Salim Jonuzi më është përgjigj – po më vjen keq që po ia përmendi emrin, po nuk po ia përmendi për të keq – Salim Jonuzi m’u përgjigj: çka po të duhet ty auditori i brendshëm, kur auditori i brendshëm është ekskluziv për kryetarin, edhe i jep llogari edhe kryetari e bën auditimin e brendshëm për me i shkue punët mirë. Edhe unë e kam ditë atë, po ai më ka sigurue, ty nuk të intereson a i kam dy a tre auditorë, ty të intereson që unë me dalë mirë në auditim. Ai tha që mjafton edhe një auditor, se s’p na lejon, atëherë ka qenë qeveria e Thaçit, tha nuk po na lejon qeveria me i punësue. Atëherë ka thënë që i kisha punësue njerëzit e mi po s’po ma lejon. Kështu në vazhdimësi është, prej kur ka qenë Salim Jonuzi. E dyta, ne të kalumen, na ka ardhë keq kur e kemi lexue raportin e auditimit. Ka pas rrugë, po jua kallxoj rastin, Restelicë-Strazimir, 101 mijë euro, asnjë baski nuk u ngulë. Kanë shkue, rruga nuk ekziston fare, u pranue. Krushevë-Zlipotok, u pranue, ose Rrenc-Kapre. Të

lutem, nuk ka, të garantoj, se e di që nuk ka. Doktor, niveli yt është krejt tjetër me atë që po dalish këtu. Lexo mirë auditorin edhe del kritiko me vend. Unë po ju betohem që jam opozita e pozitës. Por jo para jush, se ju akuzoni pa të vërteta. Ka vërejtje, normal, edhe unë i them këtë nuk bën. Për shembull, unë them filan personi nuk është i duhuri me qenë në qat vend. Por veç iu them, e ata e dinë ma mirë pse e kanë vu aty. Edhe nuk jam unë për me m' dhënë llogari, se ndoshta ai e sheh që unë e kam pas mirë, por ai e di vetë, se ai është mbreti aty. Mu po më vjen keq, pale njerëzit çka mendojnë, auditim më të mirë, besoni – tash janë zgjedhjet, ndoshta ndërron pushteti, ndoshta ndërrona edhe na, nuk do të jemi prezentë – po përmes mjeteve të informimit kemi me i pa. Çka keni bo ju në seancën e kaluar, për Radio Sharrin e keni lëshue seancën. Këta delegatë janë duke folë për auditimin, e nuk po e auditojnë vetveten. E kanë detyrë me e auditue vetveten, me dhënë kontribut për të mirën e qytetarëve, mos me e lëshue mbledhjen pa arsye. Këtu ke muhabeti. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro Raportit të Auditorit të Jashtëm? A ka kundër? Abstenim? Me 12 vota pro, zero kundër dhe 3 abstenim, e miratojmë edhe pikën e dytë. Para se me kalue te pika tjetër, a po shkojmë në pauzë apo po e vazhdojmë mbledhjen deri në ora 13:00? E qesim në votim. Kush do në ora 12:00 me dalë në pauzë? Kush do në ora 13:00 me dalë në pauzë? Shumica janë për me vazhdue dhe në ora 13:00 me dalë në pauzë. Vazhdojmë me pikën e tretë: Planin e Veprimit të Auditorit të Jashtëm. E hapi diskutimin!

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, siç thashë edhe më herët, gjetjet të cilat i ka gjet Auditori janë gjetje teknike dhe ne për këto gjetje teknike kemi përgatit edhe Planin e Veprimit të cilin e keni marrë ju si asambleistë. Keni pas kohë me e lexue. Ne e kemi përgatit edhe kohën deri kur ne duhet t'i plotësojmë këto rekomandime. Kështu që, unë nuk kam nevojë me ju humb më shumë kohë, të gjitha i keni të shkruara, dhe nëse dikush prej delegatëve do me bo pyetje, unë do të dal prapë, ose Qamili, me dhënë sqarime.

Shpetim Hajredini: E mora fjalën vetëm për një sqarim të vogël. Sa i përket Planit të Veprimit, ata të gjithë që kanë diskutue para meje e kanë diskutue Planin e Veprimit. Unë tregova, thashë janë duke diskutue për Plan të Veprimit, nuk janë duke diskutue për Raport të Auditimit. Atëherë, është dashtë të jetë si një pikë e njëjtë edhe e diskutojshna edhe Planin e Veprimit edhe Raportin e Auditimit. Gjithashtu, u bë këtu sikur në Pazar aty, e marrin fjalën edhe del këtu më tregon mu çka ka ndodhë në vitin 2021 e përpara, çka po di çka po tregon. E kemi eventualen, mund ta marrish

fjalën edhe mujsh me kritikue sa të duesh, me tregue këtu përralla sa të duash. Kur jemi duke diskutue për pikën e njëjtë, diskuto për të nëse ke njohuri, nëse nuk ke njohuri, mos del hiç, fare mos e merr fjalën. Është marri kjo çka po ndodh këtu me ne. Unë po çuditem, dalin e marin fjalën, ne kemi të bëjmë me raportin, ai del fol për atë pikën tjetër, këtij tjetrit i teket fol diçka tjetër. Nuk është në rregull. Po nuk kam çka me diskutue unë tash, se gjithçka u krye. Kryetari i dha përgjigjet, drejtori i dha përgjigjet, çka kam me diskutue për Planin e Veprimit. U krye gjithçka. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Është më se e vërtetë që e tha z.Hajredini. Unë qe 18 vjet në seancë, asnjëherë nuk është folë për pikën e rendit të ditës e me dalë në kahje tjetër. A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, e qesim në votim. Kush është pro Planit të Veprimit të Auditorit të Jashtëm? A ka kundër? Abstenim? Me 11 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe pikën e tretë. Vazhdojmë te pika e katërt: Raporti Financiar i Shpenzimeve për periudhën janar-qershor 2025. Kush do me e marrë fjalën rreth kësaj pike?

Munir Jonuzi: Faleminderit, zonja Kryesuese. Nuk do të flas shumë për këtë raport financiar, nuk do të analizoj çdo zë veç e veç, por do të ndalem vetëm te lista e investimeve kapitale që janë realizuar gjatë gjashtë muajve të kaluar. Pra, nëse e shikojmë listën e investimeve kapitale, do të shohim se janë realizuar vetëm 27 projekte – që është një numër shumë i vogël për gjashtë muajt e parë të këtij viti. Duhet që Drejtoria e Urbanizmit, ashtu edhe kompania që i zbaton projektet, të merren më seriozisht me këtë problematikë. Kanë kaluar tashmë 7 muaj të këtij viti, ndërsa janë realizuar shumë pak investime kapitale. Ju, zoti Kryetar, në takimin që u mbajt më 26 shkurt 2025, u keni ndarë detyra dhe përgjegjësi zyrtarëve që do të merren me përgatitjen e projekteve kapitale. Pse zyrtarët tuaj deri tani nuk kanë realizuar më shumë projekte kapitale? Nëse tashmë është përgatitur plani dhe janë ndarë detyrat, atëherë ka qenë për t'u pritur që deri më tani të kishim numra më të lartë dhe të ishin bërë të paktën matjet bazike për të gjitha projektet kapitale – por ato nuk janë bërë. Prandaj, ju bëj thirrje që të merreni më seriozisht me përgatitjen e projekteve për investime kapitale, sidomos në këtë periudhë kur ka një përqendrim më të madh të njerëzve – dhe jo të bëni matje "inkognito" me zyrtarët tuaj, duke u fshehur nga përfaqësuesit e këshillave të fshatrave, siç ka ndodhur edhe në raste të mëparshme. Në takimin që e përmenda më herët, pra në Bordin e Drejtorëve, mbi bazën e rekomandimit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, ju keni formuar një grup punues që ka pasur për detyrë të shqyrtojë ndikimin financiar dhe buxhetor të kontratave kolektive në vitin fiskal 2025. Ka kaluar mjaftueshëm kohë që publiku, por edhe ky Kuvend, të marrin disa përgjigje. Prandaj, ju pyes: Çfarë ka bërë ky grup punues deri tani?

Marrëveshjet kolektive nuk janë shpikje lokale – ato janë vendim shtetëror, por barra bie mbi supet e komunës. Pra, në çfarë përfundimesh keni arritur? Cilat janë rekomandimet? Shpresoj që kjo të mos jetë një nga ato grupe pune që tingëllon bukur në rrjetet sociale, por që në praktikë nuk ekziston. Pra, cili do të jetë ndikimi buxhetor dhe financiar i marrëveshjes kolektive për këtë vit 2025? Sepse tashmë po shoh se në këtë raport janë ndarë diku rreth 195,000 euro për pagesën e vendimeve gjyqësore. Pyetja është e thjeshtë: Nga i keni siguruar ato mjete? Sepse të gjithë këtu e dimë që ai zë nuk ka qenë i planifikuar me buxhetin bazë për vitin 2025. Nuk e kemi miratuar as në mbledhjet e mëparshme. Prandaj dua të dimë: A i keni marrë ato mjete nga projektet kapitale, nga subvencionet, nga shërbimet komunale? A janë sakrifikuar tashmë disa projekte kapitale për shkak të pagesës së kontratave kolektive? Sepse shoh që në disa fshatra zyrtarët tuaj nuk shkojnë as për t'i bërë matjet bazike. Faleminderit.

Driton Ademi: Përshëndetje për të gjithë! Atëherë, unë po shkoj veç te shpenzimet për Mallra dhe Shërbime. Kodi 13141 – shpenzimet e vogla, para xhepi. Cilat kategori hyjnë këtu, që është një rritje enorme, 6296 euro. Në krahasim me vitet e kaluara është një rritje enorme. Më përqindje po i bjer diku 154%, nëse është kështu. Kodi 13440 - Shërbimet këshilldhënëse dhe profesionale, drejtor, nëse bën me e ditë, cilat projekte hyjnë këtu, qe ky kod po më vjen se nuk e kam parë vitet e kaluara. Këtë kod po e shoh të ri. Te pjesa: Pajisjet speciale mjekësore - furnizim mjekësor është 53 mijë euro - është mirë që është bërë furnizim mjekësor, po kah e gjetët këtë kodin 13506 – Pajisje speciale mjekësore. Këtë kod unë nuk e kam parë ndër vite, 96 euro ku i keni marrë që i keni pague? Kodi 14023 - Mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve, 15 mijë euro. Domethënë, rritje nga vitet e kalume në këtë vit. Vitet e kalume kanë qenë 500, 1300, këtë vit janë 15 mijë e gati 100 euro. Drekat zyrtare, 230%, nga 4300 euro në 9821 euro. Për gjashtëmujorin e parë. Kjo është një katastrofë. Subvencionet dhe Transferet, kryetar, 21200 – subvencionet për entitet jopublik, ju po thoni që ne po i rritim, po ju këtë vit fatkeqësisht i keni zvogëlue diku për 11 mijë euro. Edhe plus, kur të dalish me kqyr subvencione, ka disa prej këtyre, në mos gabofsha, të reja, disave jau kanë ulë, disa i kanë rrit çmimet që jau keni lëshue subvencionet këtyre OJQ-ve. Shpenzimet për investime kapitale – kodi 31230, ndërtimi i rrugëve – unë nuk e di, s'po besoj e as që kam pa najherë që, mos gabofsha, mas 20 marsit është lëshue buxheti, për dy muaj e gjysmë ju me mbërri me i pague 531 mijë euro. Qekjo po më duket shumë absurde. Po ju i keni bo punët, se tash thoni kanë mbet të vitit të kaluar, qeshtu e keni stilin. Kodi 31510 - Pajisjet për gjenerimin e energjisë elektrike dhe ndriçim publik, 270 mijë euro. Kryetar, me sa e pashë të investimet kapitale, te

ndriçimi publik që është në Rrenc, Kuklibeg, Brrut, Pllavë, Glloboqicë, dikund – unë qysh i kam mbledhë – po dalin dikund rreth 93,260 euro, në mos gabofsha. Çka është paguar me 270 mijë, kurse ndriçim publik po më dalin këto. Nëse bën me e dit një sqarim pak më të gjerë. Edhe te shpronësimi i tokave, ku është bërë qeky shpronësimi i tokave – kodi 32100. Drejtorit t'ia jap një përgjigje. Drejtor, ti thaje kemi gjenerue të hyra nga viti në vit. Unë veç po të them, vetëm 9 mijë euro i ke gjenerue për gjashtëmujorin e parë, kurgjo ma shumë. Vitin e kaluar i ke pas 187 mijë euro, kurse këtë vit i ke 196 mijë euro. Domethënë, nuk ke të hyra pale se sa të gjenerume. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Faleminderit për pyetjet! Është mirë me u interesue për shpenzimet, realisht edhe keni të drejtë. Shpenzime, para të xhepit, kemi bërë disa pagesa nën 100 euro, disa furnizime të cilat nuk po mund t'i furnizojmë përmes kontratës që e ka lidhë Qeveria. I kemi marrë disa tonera që jemi detyruar me i marrë, përndryshe nuk ka. Me prit derit 'i bjerë Qeveria, deri t'i bien furnitorët, po dalim shumë qesharakë. Në Zyrë të Pritjes kemi pas rastin, për një muaj ditë nuk na ka pru tonerin, jemi detyrue me i ble. Nëse mendoni, haje po e mbyllim, po e lëmë, po presim kur të na bien. Do sende shumë thjesht, Driton, duhet me u bo. Ndaç kesh unë, ndaç ke ti në qeveri, ndaç tjetri kur të vjen, diçka që duhet me u bo, duhet me u bo. Një zgjidhje duhet me u gjet. Mu nuk po ma merr mendja që kjo foltore është për me vajtue na. Kjo foltore është për me gjet zgjidhje. Me qenë korrekt me vetveten edhe korrekt me qytetarët. Janë shpenzime shumë normale që i kemi bo. Për pajisjet speciale mjekësore, të drejtën me ta thënë... kodet ekzistojnë, nuk mundesh ti kur të teket me shtue kod edhe kur të teket me hek. Me shtue mund të shtohet me leje të Qeverisë, po me e hek nuk hiqet. Mund të ketë shpenzime. 13440 – Shërbimet këshilluese dhe profesionale, janë ato shpenzime të cilat janë përdorë, pagesat që janë bërë për shërbime profesionale, në shëndetësi. Po këto nuk janë ndonjë farë problemi. Furnizime mjekësore, dihet, barnat, 53 mijë euro. Kontrata është ajo e cila ka qenë edhe e kemi diskutuar. Mirëmbajtja e pajisjeve dhe mobiljeve, kemi pas rastin që kemi ble mobilje të reja edhe disa mobilje i kemi ndërruar nëpër zyra. Janë këto shpenzime të cilat janë krijuar. Drekat zyrtare, kemi pas dreka. Kur punohet shumë, ka nevojë edhe me prit delegacione ma shumë. E kemi pas gjithashtu edhe muajin e Ramazanit, kemi pas edhe takime të ndryshme, sepse deri sa të ftojnë edhe duhet dikund me ftue. Po ne realisht i kemi pas këto, ma merr mendja janë të gjithë regjistrat, asnjë shpenzim nuk është bërë i paarsyeshëm. Subvencionet i ka ndarë një komision i cili është përgjegjës. Disa OJQ të cilat janë ankuar për shumën e subvencioneve, komisioni ka vlerësue që do të japë dhe në këtë raportin

gjashtëmujor nuk janë regjistruar si mjete, jepen në gjashtëmujorin tjetër, figurojnë organizatave joqeveritare. Ato që i ka vlerësuar komisioni t'u jepen mjete shtesë, ne u kemi lëshuar edhe mjete shtesë. Për këtë gjashtëmujor kaq kemi pas pare, kaq i kemi krye obligimet, dhe kur të bëhet pagesa pas qershorit automatikisht del për gjashtëmujorin tjetër në raport dhe do ta kesh edhe atë të dhënë.

Bexhet Xheladini: U përmend se vetëm 27% të investimeve kapitale janë bërë pagesat. Unë ju garantoj që deri më tash mbi 50% e projekteve kapitale janë përfunduar. Po normal, janë procedurat e pranimit të projekteve, komisioneve etj., dhe derisa kompania ta bjerë faturën e pagesës mund të shkojë edhe një muaj. Kështu që, unë ju garantoj që deri në fund të vitit, të gjitha mjetet të cilat janë paraparë për investime kapitale do të realizohen dhe asnjë mjet nuk do të kthehet mbrapa. Ishalla do të kemi mjete për me shpenzue, se për me i shpenzue do t'i shpenzojmë. Mbi 90% e investimeve kapitale janë në procesin e tenderimit, megjithëse kemi pak probleme, nuk kemi kompani, po na dështojnë disa tenderë. Ka tender ku nuk paraqitet asnjë kompani me e marrë punën. Ka ndonjë kompani që del me qëllim mbi çmim, me dështue projekti. Po megjithatë ne jemi duke e bërë ritenderimin e tyre dhe jemi duke e rritur shumën e mjeteve, po edhe na ato ku nuk është bërë planifikimi i mirë, po i bëjmë projekte dyvjeçare. U përmend këtu prapë përmbauesi. Këtë vit deri më tash përmbauesi na i ka marrë 200 mijë euro nëpër projekte të ndryshme. Te kodi 13141 është fjala për mëditjet e delegatëve, këtu janë mëditjet e juaja. 13440 është KKSB-ja, pagesat e KKSB-së. Kodi 13630 janë barnat dhe mjetet e laboratorit. 14023 – është fjala për renovimet e shkollave fillore. Për subvencionet, ende nuk i kemi përfunduar, vetëm OJQ-ve e shoqatave ua kemi lëshuar. Ndërsa për disa, vendimet janë të shtypura por nuk janë ekzekutuar, varësisht prej Komisionit, i cili ka vlerësue për shumën, dikut i ka dhënë më shumë e dikujt më pak. Dy prej OJQ-ve apo shoqatave janë ankuar, Komisioni i Ankesave ua ka pranuar ankesat edhe atyre të dyjave u janë rritur subvencionet. Sa i përket kodit 31230, është fjala për pagesën e projekteve dyvjeçare. Te 31510, kanë qenë të parapara 270 mijë euro, ndërsa janë realizuar 97 mijë apo 92 mijë, sa ishte. Përmbauesi i ka marrë këto pare dhe, normal, aty ku kanë qenë të planifikuara, edhe pse i ka marrë përmbauesi, ato parashihen si shpenzime. Shpronësimi – kodi 32100 – është fjala për shkollën e Zgatarit. E dini ju, Asambleja Komunale, 30 mijë euro, i kemi 120 mijë euro me i pague Bashkësisë Islame për atë tokën ku është ndërtuar shkolla fillore në fshatin Zgatar. Më duket në vitin 1999 është ndërtuar, nuk e di, shkolla është ndërtuar në tokën e Bashkësisë Islame pa e pyetur Bashkësinë Islame. Edhe tash Bashkësia Islame e ka padit Komunën, ose më duket ka bërë marrëveshje me ju, me qeverinë e kaluar, kjo Asamble e ka votuar

që me ia bo pagesën fshatit Zgatar edhe kur e kam marrë unë pushtetin, si kryetar, ka hyr kjo në fuqi, edhe ne tash e kemi bërë një marrëveshje me Bashkësinë Islame që brenda tri viteve me ia pague këtë shumën prej 120 mijë euro. Ne një këst ia kemi paguar, 30 mijë euro, kemi paraparë edhe për vitin e ardhshëm një shumë tjetër, edhe për vitin tjetër. 13440 unë të thashë që është KKSB-ja, janë pagesat e KKSB-së. Kemi pas disa telashe me pagesat e KKSB-së, dy vite nuk kanë marrë fare pagesë, edhe e kemi gjet një formë tjetër të pagesës, por prapë edhe ajo më duket do të bllokohet, kështu që do të ketë probleme.

Driton Ademi: Kryetar, veç te qekjo pika që ta bona pyetjen tash. Për sa vite janë paguar këto të KKSB-së, nëse jeni në njohuri. Edhe pyetja e dytë, a kanë mund me hy qetu edhe kryetarët e fshatrave, te qekjo pika, 13440? A kanë mund me këtë pikë me i shti edhe kryetarët e këshillave të fshatrave. Faleminderit!

Munir Jonuzi: Zoti Kryetar, më vjen mirë që zyrtarët tuaj i kanë kryer matjet për të gjitha projektet kapitale në territorin e komunës sonë. Mirëpo, e di gjithashtu se përqindja është e lartë, siç thoni ju – 90%, por e di që në Rapçë nuk keni qenë. Ose ndoshta sërish keni qenë fshehurazi. Me Këshillin e Fshatit nuk kanë biseduar zyrtarët. Ne, duket se i kemi themeluar këto Këshilla të Fshatrave vetëm sa për t'i pasur, vetëm sa për të marrë pikët e “grantit të performancës”. Por detyra e Këshillave të Fshatrave është të përgatisin listën e projekteve kapitale për fshatin, se si do të zhvillohet. E tani, z. Kryetar, nëse i keni përfunduar projektet në Rapçë, flas hipotetiki, nëse i keni përfunduar matjet në Rapçë, atëherë e keni shkelur fjalën tuaj. E keni premtuar vitin e kaluar se nuk do të bëni asgjë, e keni premtuar atij Këshilli të Fshatit që ka qenë këtu, se nuk do të bëni asgjë në fshat pa u konsultuar me ta. A është e mundur, z. Kryetar, që ju nuk e mbani fjalën? A është e mundur që nuk keni besë, që nuk qëndroni pas fjalës tuaj, që nuk e respektoni fjalën e dhënë? Nuk dua ta besoj këtë, por nëse zyrtarët tuaj kanë qenë, atëherë ju duhet të merreni me këtë çështje, z. Kryetar, duhet të shqetësoheni se çfarë zyrtarësh keni. E di që ata e bëjnë këtë me qëllim dhe me direktiva të drejtorit të Urbanizmit, por kjo do t'ju hakmerret në zgjedhje. Dhe, z. Kryetar, nuk më dhatë përgjigje në pyetjen se çfarë ka bërë deri më tani grupi punues që është dashur të analizojë ndikimin buxhetor dhe financiar të marrëveshjeve kolektive në vitin fiskal 2025. E keni themeluar atë grup punues, çfarë ka bërë ai deri më tani? Janë bërë 5 muaj që kur e keni themeluar, më 26 shkurt, tani jemi rreth 29 korrik, kanë kaluar 5 muaj, në çfarë përfundimesh keni dalë? Cili është ndikimi i marrëveshjeve kolektive në buxhetin dhe aspektin financiar të vitit fiskal 2025?

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Atëherë e qesim në votim. Kush është pro Raportit Financiar të Shpenzimeve për Periudhën Janar-Qershor 2025? A ka kundër? Abstenim? Me 13 vota pro, 2 kundër dhe 3 abstenim, e miratojmë edhe pikën e katërt. Vazhdojmë te pika e pestë: Informatë lidhur me punën e KKSB-së për periudhën janar-qershor 2025. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 14 vota pro, 1 kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe pika e pestë. Vazhdojmë me pikën e gjashtë: Rishqyrtimi i Vendimit 01Nr.060/01-11859-2/25 të datës 30.06.2025 për miratimin e Listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Dragashit. A do dikush me e marrë fjalën lidhur me këtë pikë?

Driton Ademi: Atëherë, nëse bën, arsyetimin e kësaj – edhe pse e keni nëpër materiale – Ministria e ka përmend, pas shqyrtimit të Vendimit të lartcekur konstaton: emrat e rrugëve, para se të dërgohen në miratim në Kuvendin Komunal duhet të dërgohen më parë në Agjencionin Kadastral të Kosovës për shqyrtim teknik, sipas Udhëzimit Administrativ Nr.16/2019 për Procedurat e Krijimit të Administrimit të Regjistrimit Komunal të Adresave dhe Regjistrit Shtetëror të Adresave, të Nenit 9, Pika 1.3: Komuna nuk ka dërguar këtë listë për shqyrtim paraprak në AKK, gjë që përbën shkelje procedurale. Kryetar, nuk kam qenë pjesë e seancës së kaluar, mu po më vjen keq – nuk e kam kolegun këtu – edhe në seancën e kaluar kam pas me folë. Duke u bazuar në Vendimin e Komunës, të datës 18.12.... në përbërje të Komisionit: Nexhat Selaj, Gazmend Ramadani dhe Munir Jonuzi, unë dua me e pyet Nexhat Selajn, Gazmen Ramadanin dhe Munir Jonuzin, as këto listat nuk janë të nënshkruara prej tyre, as kur kanë ardhë në seancën e kaluar, as sot – nejse, sot nuk po e shoh nashta edhe shumë të arsyeshme. Por unë, diçka që dua me i pyet anëtarët e Komisionit, që atë ditë e keni kaluar këtë pikë veç si shkelje dhe shko, a bën me e ditë ku i keni marrë këta emra, këto emërtimet kush jau pru? Munir, kush jau pru? Edhe Gazmend, masi nuk është Nexha, edhe atë. Nuk është e rëndësishme vetëm sa me hi me një komision, po këta emra prej kujt kanë ardhë? A ka mundësi me e ditë? Unë për afërsisht e di, veç s'po due me përmend jashtë Kuvendit emrat ku kanë ardhë. Se veç dihet prej kujt janë ardhë këta emrat. A i keni pyet këto lokalitetet këtu, emërtimin nëpër lokalitete, a jo? Shoku Gazmend, po ta përmendi emrin, diku mbi 50 emra janë veç të fshatit Brrut. A i ke pru ti si Komision, a kush t'i ka pru? Del me përgjegjësi, se kam informata tjera. Është mirë me dalë, se këto prapë nuk kanë me të kaluar, këto

emërtimet. Edhe, nëse ka mundësi, a keni dalë në terren – unë më sa e di, asnjëri nuk keni dalë në terren. Unë e pyeta veç pak a shumë profën, më tha neve nuk na ka pyet kërkush, veç na kanë pru hazër këto emërtimet. Po unë e kam anëtar të Komisionit, Samidin, unë nuk të kam faj që është anëtar i Komisionit, emrat këtyre veç iu kanë ardhë hazër. A në vend se këta me dalë nëpër lokalitete me i marrë emrat, këta hazër i kanë marrë emrat prej dikujt që jau ka pru juve si në pushtet këtu. Nuk po due me hy shumë thellë, se po dihet ku janë emrat. Kjo pak ka rëndësi, po kryesore anëtarët e Komisionit, me sa kam informacion, nuk janë pyet, edhe qeta emra janë pru në Kuvend hazër. Edhe neve me e miratue këtë, për këtë ka mundësi që prapë ka ma jau kthye, se ju nuk e keni pyet asnjë fshat, as kryetar të fshatit, as kërkond, për emrat e rrugëve. Veç i keni pru paushall qetu, edhe na me jau miratue këto nuk guxojmë. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Atëherë, nëse nuk ka, e qesim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 10 vota pro, 8 kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë te pika e shtatë: Shqyrtimi i kërkesës së z.Burim Piraj për ndërrimin e destinimit të tokës. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Në qoftë se jo, e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 13 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Edhe 15 minuta kemi kohë deri kur e keni dashtë vetë pauzën. Vazhdojmë deri në ora 13:00! E lus Radio Sharrin që të kthehet kah Asambleja, sepse shumica veç kanë dalë. Ma mirë po e vazhdojmë deri në ora 13:00, përndryshe nuk kanë me na u kthye krejt, ata veç tash kanë zënë me e lëshue sallën. Atëherë, vazhdojmë te pika eventuale! Kush do me e marrë fjalën rreth pikës eventuale?

Driton Ademi: Atëherë, i kam disa – shpresoj se drejtori për Arsim, po nuk qenka – jo, nuk i kam pyetjet e shkruara, kryetar, kështu që, nëse ke mundësi, shkruaj, nëse nuk ke mundësi, është për ty. Para se me t’u përgjigj ty, kryetar, po due me iu përgjigj kolegës ma herët. Agron – senuk deshta me dalë, për atë e ndërpreva, i thashë kryesueses. Agron, ta kam thënë edhe herën e parë, po diqysh sikur me ta hek vërejtjen po duhet me u bo. Unë me u bo në vend të kryesueses. Rri more burrë në cilën pikë je! Edhe kur të dalish me folë, a je t’u e ditë që ke qenë në qeverisje më herët a jo? Ku je, a veç ke hi sa me e marrë një rrogë këtu? Unë shok të kam, po është e tepërt me dalë jashtë pikës së rendit të ditës. Çdo seancë e jotja po shkon jashtë pikës së rendit të ditës. Kjo është jashtëligjshëm, për mendimin tem. Edhe, shpresoj që je kënaq në det, bashkë me Samidin që jeni konë me Administratën, të dytë, kështu që mos harroni. Që jeni konë bashkë me Administratën. Me çfarë vendimi dy asambleistë janë marrë me Administratën, që jonë konë bashkë me ju në det?

Pyetja e parë është kjo. Pyetja e dytë, dje paska dalë konkursi për infermierë, edhe me sa e pashë, Sabrie Kolloni – qika e motrës së kryesueses - dy vetë paskan marrë, mos gabofsha, mbi 50 pikë i ka qika e motrës së kryesueses. Nëse është qekjo, në bazë të informacioneve, Sabrie Kolloni, dhe Sihana Ramadani, me sa e kam pa unë, kandidatë për Asamble. Domethënë, vetëm dy veta e kanë kaluar testin për infermierë që i kanë thirrë për intervistë. Pika e tretë, kryesuese, që duhet ta bëjë një pyetje shumë interesante – se shpeshherë po lidhet me Samidinin, po as Bresanën nuk po duhet me e lënë mangu. Kryetar, unë e di që e ke marrë djalin e baxhanakut në punë, në Bresanë. Krejt në rregull, e ke marrë qysh e ke marrë. Ama, a nuk ka kurira tjerë, që djali i baxhanakut përfiton çdo muaj shtesë. Çfarë pune bën ai të shtunat e të dillat? Asnjë kurir në botë nuk paguhet, ai punon të shtunat e të dillat. Edhe i kam me shifra, veç po ta lexoj muajin e fundit që i ka marrë shtesë 112 euro. Të muajit qershor. Në mos gabofsha, 112 euro e 60 centë është e marrur. Plus këtu, pas manifestimit, prapë ka dalë djali i baxhanakut tënd me pastrue. A ka me marrë mëditje edhe këtë muaj, kryetar? E ke pas edhe në KQZ. Tjetër kush është punëtor i kalldajit, e keni shti atë si punëtor të kalldajit, atë tjetrin e keni përjashtue. Domethënë, mëditje çdo muaj, edhe me orë plus i ka marrë prej janarit deri në qershor. I kam të shënuara edhe me shuma. Nuk e di a duhet çdo muaj qekjo me u bo, a jo? Nuk po due me ta përmend emrin, po aty është për me aplikue, kush aplikon munden me shkue. Kryesuesja nëse ia ka dhënë emailin veç temin, po më vjen keq, munden me ia dhënë të kujt të do, munden me ia dhënë të krejtve. Aty duhet me e kthye një përgjigje, a marrish pjesë a jo. Edhe sot kemi qenë të ftuar, po nuk kemi marrë pjesë. Kryetar, po due me u lidhë pak, edhe pse nuk jemi konë, prapë po them, ndoshta unë kam kërkue që s’kam me e lëshue sallën, por për shkak të grupit është dashtë me u lëshue salla. Atëherë, po lidhem pak te Lista e shpenzimeve që e kemi pas te KAB-i në muajin e kaluar. Ndrëçim publik në qendër të fshatit Kuklibeg – 30 mijë euro. Mos gabofsha, 30 mijë kanë qenë vitin e kaluar, sivjet edhe 20 mijë. 50 mijë euro ndrëçim publik në Kuklibeg, unë nuk o e di, Bresana i ka pas 60 mijë. A qaq Kuklibegu është i madh që 50 mijë euro ndrëçim publik, a? Kubëzim i rrugëve qendra e fshatit Buzez – 69 mijë euro, plus 28 mijë. Vitin e kaluar 70 mijë euro, sivjet edhe 28 mijë. Unë nuk e di ku jeni duke i çue këto. Shtronja edhe dhomat ma mirë qaty me kubëza, se s’po di çka ka mbet tjetër. Prapë qe po ta lidhi te ndrëçimi publik: Ndrëçim publik në qendër të fshatit Pllavë, vjet 20 mijë, sivjet 45 mijë. Hajt qe, a jam i padijshëm? Vjet 20 mijë, sivjet 45 mijë, e ke planifikue, se tash deri në miratim të buxhetit ne hala nuk e dimë çka munden me ndryshue. Po masi nuk kam qenë në seancën e kaluar, këto pyetje po due me t’i bo. Ndërtimi i këndit të lojërave, kubëzimi dhe demolimi i shkollës së vjetër “28

Nëntori” në fshatin Bresanë. 30 mijë euro vitin e kaluar i kemi nda qetu. Plus 23 mijë euro! Çka ka me u vonue, park i lojërave, u prish një shkollë, një mur ka me u bo, parku i lojërave - 53,900 euro. Me 50 mijë na e kemi vonue një shesh, e kushedi sa kubëza e sa sende. Ju, vitin e kaluar, edhe pse ka qenë projekt dyvjeçar. 23,900 euro janë planifikue në KAB, 30 mijë euro kanë qenë vjet. Po kush i mori, o kryetar? Unë po pyes, qeto 30 mijë eurot që ti i ke nda, i ka nda Kuvendi. Kryetar, veç pak, se po e keqkuptojnë. 30 mijë eurot i ka nda Kuvendi. Tash, është e drejtë e jotja, normal, ligjore, që ti mu me ma shpjegue që i ka marrë përmbaruesi. Krejt në rregull jemi, nuk po të kundërshtoj kurgjo, po unë po due me thënë që 30 mijë i kemi nda vjet në miratim të buxhetit, plus 23 mijë euro. 53 mijë euro! Diçk apo më vjen se do investime që as nuk janë duke u prek fare. Edhe pjesa e qendrës, në çfarë investime të kubëzave je duke bo, copa-copa, që është duke u coptue udha e qendrës, prej udhës Urës së Madhe deri te Xhamia, a bin me e ditë? Ma mirë ka qenë me i pas lënë qashtu, sa që është duke hy nëpër midis, është duke çelë gropa edhe uji është duke dalë në çdo vend. Që je aktiv, që je duke dalë nëpër qendër – nashta po e marrish si lloj kritike, po unë po ta them për të mirëqenë, që me e marrë pak më të mirë, se qato kubëzat që janë duke u shtrur nëpër qendër, prej Urës deri te Xhamia, është katastrofë e madhe. Domethënë, kanë lënë edhe hapësirë, po e mbushin me zall. Nuk e di kush është mbikëqyrës i tyre, është mirë kur të dalish me i verifikue a është qashtu. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Atëherë, u bë një pyetje, pse dy asambleistë kanë shkue në pushim. Unë si kryetar i Komunës kam qenë në pushim privat. Edhe pse kam shkue zyrtarisht, jam takue me kryetarin e Lezhës, kam vazhdue une edhe dy ditë kam ndejt, me shpenzimet e mia. E kam faturën që e kam pague me pare CASH, bile i kam paguar edhe shpenzimet e vozitësit. Por, ai i cili më ka akuzue mu që unë kam shkue me pare të shtetit, pas zgjedhjeve do ta paditi në gjyq. Po pres me mbledhë edhe pak më shumë pare, edhe të gaboje hala ma shumë, unë e kam përgatit veç lëndën, po do ta çoj pas zgjedhjeve. Sa i përket konkursit, u përmend, janë qit rezultatet, është qit konkursi për tre, e kanë kalue dy. Paskan kalue dy, unë nuk e kam parë, sot e mora këtë. Sot ka dalë, a? Thashë unë për asambleistët, kanë shkue por unë nuk kam qenë person kompetent i cili e ka bo listën. Ky më ka lut disa herë unë i kam thënë kategorik jo. Mua asambleistët nuk më kanë pyet, Samidni më ka pyet, i kam thënë jo edhe pikë. Mandej, unë kam shkue një ditë më vonë, se e kam pas takimin ditën e premtë me kryetarin e Lezhës.

Arijeta Skeraj: Uran, seriozisht po më vjen marre prej vetes me ta tërhek vërejtjen shumë herë. Kur të del kryetari i Komunës, ose mos lypni me dalë. Kur s’po del me ju dhënë përgjigje, jo, nuk

është këtu. Këtu ka qenë gjithmonë për përgjigje. Të vetmit ju që po të detyroni kryetari me dalë. Po të jep sqarime, po të jep përgjigje, ti nuk qetësohesh, o Uran. Çka kie që nuk je i qetë? Duhesh me i shpjegue këto sende, del në foltore edhe fol, kërkush nuk po ta ndalë. Të lutem, më mos ndërhyj!

Bexhet Xheladini: Unë ta thashë, Samidini më ka pyet, i kam thënë jo. I kam thënë që nuk jam unë kompetent, tjetërkush është i caktuar që e bën atë listë. Kur kam shkue një ditë më vonë, e kam parë atje, as nuk e kam parë kur ka shkue. Unë, të thashë, kam qenë zyrtarisht, edhe jam kthye prapë më herët se këta. Për konkursin, të thashë, kryetari i Komunës i kryen këto procedura në pranimin e punëtorëve: së pari, kryetari i Komunës e nënshkruan aplikacionin për hapjen e vendeve të punës, edhe kryetari e di kur duhet – një herë, së pari duhet me pyet a ka buxhet. Pastaj, nëse ka buxhet, duhet me pyet a ka vende të lira të punës në atë institucion ku duhet të bëhet punësimi, sepse kërkesa bëhet prej drejtorëve dhe vjen te unë, te kryetari. Kryetari atëherë vendos a me e hap konkursin apo jo. Kur vjen formulari me kërkesë se ka buxhet edhe ka vende të lira të punës, ka kod të punës, ka nevojë ,unë e nënshkruaj. Pastaj formulari shkon në Zyrën e Personelit. Zyra e Personelit i kryen të gjitha procedurat e shpalljes së konkursit, procedurat e formimit të pyetjeve, testeve dhe të gjitha procedurat që janë të caktuara me ligj. Ata të cilët janë të pakënaqur, normal, ligji ua lejon me u ankue. U përmend ndriçimi publik në Kuklibeg, u përmendën disa shuma para dhe pas. Ndriçimi publik në Kuklibeg është dyvjeçar, edhe nuk është bo aty pazar, po ndriçimi publik ka dalë në tender dhe ka qenë një tenderues, një aplikues, edhe e ka marrë ai, çmimin sa e ka marrë nuk e di sa ka qenë. Punimet janë kryer, edhe pse është projekt dyvjeçar. Një pjesë e mjeteve janë paguar sivjet, një pjesë kanë me iu pague në mot. Kompania me paratë e veta ka investue edhe e ka krye projektin, në mot i merr paret. Dëgjo, në Bresanë u krye ndriçimi publik para tri viteve. Atëherë ka qenë krejt tjetër çmim, sot ke krejt tjetër çmim. Ka pas që unë e kam mbërri deri në 13 mijë euro kubëzat, tash nën 24 mijë euro kërkush nuk hi me i shtrua kubëza rrugët. Në Buzez është projekt dyvjeçar. Janë të parapara mbi 90 mijë euro, afër 100 mijë euro. Vjet kanë fillue me u kubëzue rrugët, kanë me u kubëzue edhe sivjet. Kur të kryhet projekti, mjetet janë, kanë me u bo pagesat. Edhe në Pllavë është e njëjta, ndriçimi publik është dyvjeçar. Te Bresana, ky projekt ka pas me u bo vitin e kaluar. Janë marrë mjetet me procedura gjyqësore, nga përmbaruesi. Kët vit kjo Asamble, edhe ti ke votuar, kur janë bërë bartjet për këto mjete, ke votue edhe ti. Ka votue kjo Asamble edhe këto tash ato punët që kanë pas me u krye vjet, janë duke u krye sivjet. U bo demolimi i shkollës, do të ndreqet ai muri i cili bën ndarjen e pronës private prej

pronës shoqërore, po kryhen qato kubëzat që po thuesh ti ka probleme në qendër të fshatit. Kanë me u krye edhe disa kubëza tjera, disa punime, diku nën 30 mijë euro është marrë ky tenderi, nuk e di sa. Ka kompani aktive, ekziston kontrata, mirëpo prishjet kanë qenë shumë të mëdha. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Në ora 14:00 kthehemi në seancë!

(Pas pauzës)

Arijeta Skeraj: Atëherë, po fillojmë me pjesën e dytë! Siç po shihet në sallë nuk ka kuorum, por është disponimi i disa asambleistëve që ta vazhdojmë, është edhe disponimi i kryetarit me dhënë përgjigje. Është mirë që po fillojmë edhe po mundim me diskutue, pasi që nuk kemi me marrë ndonjë vendim. Atëherë, e fillojmë këtë pjesë të dytë të Asamblesë! Ado dikush me e marrë fjalën?

Shpetim Hajredini: Atëherë, unë pak do të lidhem me atë fjalimin e kolegut asambleist, edhe pse nuk është për momentin këtu – Agroni – i cili, në pikën e parë kur e diskutuam Raportin e Auditorit, ai ai doli dhe i preki do tema të cilat nuk kanë të bëjnë me auditim. Por, nuk dua ta lejoj atë që të mendojnë qytetarët që atë që e tha ai është realiteti. E përmendi çështjen e ujësjellësit dhe e dha mendimin e tij. Deshta t’i tregoj Agronit që projekti i Ujësjellësit është projekt i PDK-së. Dihet që ky projekt ka filluar nga PDK-ja të realizohet, janë ndërtuar një pjesë e rrjetit. Nëse nuk jam gabim, edhe nja dy rezervarë, nuk i di vendet. Po më duket ka qenë Brruti dhe Rrenci që kanë qenë të ndërtuar. Pastaj, në vitin 2016, në mos gabofsha, ka ndodhë ai problemi i ankesës dhe ka shkue e u bart çështja në OShP. Edhe anasjelltas, ka vazhdue edhe përmes gjykatës, ku i ka dhënë të drejtë Komunës që ta rikthejnë edhe në pikën zero. Mirëpo, një gjë e tillë nuk ka ndodhë, nuk e di çka ka ndodhë pastaj. Deri në momentin kur erdh dhe u ndërruan anëtarët e OShP-së. Anëtarët e OShP-së janë ndërrue në vitin 2021-22, dhe pastaj më nuk ka pas ankesa, dhe jemi sot kur ky projekt po realizohet. Unë e falënderoj Zotin që po realizohet përfundimisht dhe ato fshatra të cilat deri më sot nuk kanë pas ujë, do të kenë ujë. Mirëpo, unë kisha pas dëshirë që qytetarët ta dinë se pse është zvarrit për këto vite, dhe besoj që ata e dinë. Por edhe nëse nuk e dinë, ka njerëz që e dinë se kush e ka zvarrit dhe çka ka bo. Është Ai atje lart që na ka krijue, e mjer ai ku ka me shkue nëse ai apo ata e kanë bo një gjë të tillë për pozitë. Tjetra, kontratat kolektive, i përmendi shpenzimet kinse ne ia lënë këtij ekzekutiv. Deshta t’i jap sqarim Agronit dhe t’i tregoj. Zotëri Agron, në momentin kur është bërë kërkesa e kontratave kolektive – drejtori i Financave është këtu dhe po e sheh se çka ndodh nëse nuk e ke një kod buxhetor të veçantë për pagesën e një projekti apo një çështje tjetër, siç janë kontratat kolektive. Në atë kohë, kod të veçantë buxhetor për pagesën e këtyre

kontratave nuk ka pas dhe mundësitë kanë qenë zero dhe nuk ke mund me e bo pagesën. Ka qenë edhe një kod tjetër që në kohën e PDK-së, është marrë vendim që të jetë një kod i veçantë dhe të jetë një shumë e veçantë për rritjen e pagave. Unë e mbaj në mend mirë atëherë, kur e kam diskutue me drejtorin e atëhershëm të Financave, e kemi diskutue shumë qartë. Tha që kene mundësi të fillojmë të bëjmë pagesën, mirëpo Ministria nuk po ma lejon. Këtë kod buxhetor që kemi mundësi përmes tij ta kryejmë pagesën, ajo nuk po na lejon ta bëjmë një gjë të tillë. Mund t'i përdorim në çdo kod tjetër, kudo që të kemi dëshirë, por për kontratat kolektive nuk kemi të drejtë. Kjo është e vërteta, Agron. Besoj që e dëgjon, nëse nuk e dëgjon, mujsh me hy prapë me kqyr çka kam folë dhe këto janë me argumente. Dua të lidhem pak me problemet e fshatit Kuk. I nderuar, kryetar, mbi një vit ka kur Krijuesi na dërgoi atë vërshim dhe patëm dëme të konsiderueshme në infrastrukturë. Një pjesë e mirë e tyre është evituar dhe kubëzat janë rikthyer, rrugët janë të kalueshme, janë mirë. Por, një pjesë shumë e vogël që, besoj, është dashtë të jetë pjesë edhe e projektit që janë realizuar këto, metër katrorë, është dashtë të jetë edhe ajo pjesë, se është shumë e vogël, është bon vaki, me thënë – nuk e kam mat – po nuk e di a është 70-80 metre a 100 metre, nuk e di saktësisht. I bjer tek Mëhalla e Kelaje. Është njëfarë reshetke që kalon uji kur vjen prej bjeshkës, hyn edhe kalon në lumë, e ma lart. Ajo pjesë është dëmtuar keq. Tani edhe kur bashkatdhetarët kanë ardhë, po e frekuentojnë atë rrugë, po shkojnë për bjeshkë, ajo po iu hap problem. Kisha pas dëshirë që ju me kontaktue me kompaninë e cila e ka pas këtë projekt, që ta finalizojë edhe ta përfundojë edhe atë pjesë, e cila është pjesë shumë e vogël, pasi që ne e dimë projektin, paramasën, e dimë si ka qenë dhe si është realizuar në punime gjatë evidentimit dhe eliminimit të problemeve të vërshimeve. Prandaj, unë besoj që ka hapësirë që edhe kjo pjesë e rrugës të rregullohet po me atë buxhet. Tjetra, unë tash e dëgjova prej teje, kryetar, nuk po di nëse e kam dëgjue mirë, saktë. Thaje që është kompania që e bën mirëmbajtjen e ndriçimit publik. Unë deri dje në fshatin tim e kam bërë mirëmbajtjen vetë, edhe vazhdoj hala me e bo vetë. Nuk e di që ka ndonjë kompani që vjen i eviton problemet e ndriçimit në fshatin Kuk. Dje kam vazhdue me i ndërrue qato dritat që kanë qenë të djegura. Me pas ditë që ka kompani, nuk kam nevojë unë me i shti njerëzit me tubue pare prej bashkatdhetarëve dhe me e bo një gjë të tillë. Tjetra – pasi tash edhe nënkryetarin e kemi këtu, besoj që ka qenë kompetent ky projektet të cilat ka kërkuar që të finalizohen në vitin e ardhshëm – unë në KAB atë ditë nuk kisha se atë ditë e kisha kërkuar një gjë të tillë, ka të bëjë prapë me ndriçimin publik. E di nënkryetari se janë disa rrugica të vogla që çojnë nëpër disa shtëpi që nuk janë të ndriçuara. Kur e kemi bo ne ndriçimin e fshatit, e kemi pas si kriter

mos me hi nëpër disa familje, shkurtimisht. Andaj, kërkoj që ta ketë parasysh Resuli, prej cilitdo projekt që ka mundësi, të bëjë ndarjen prej 10 mijë euro që në vitin 2026 ndriçimi të shtrihet edhe nëpër këto rrugica të vogla. Prej cilitdo projekt që ka dëshirë ky, le ta bëjë bartjen dhe le të jetë edhe një projekt i ri për fshatin Kuk, po nga ai buxhet të cilin ju vetëm e keni ndarë për fshatin Kuk. Një ankesë që ma kanë dërgu fshati Kuklibeg, ka të bëjë me atë kanal in ujor i cili është ndërtuar përreth rrugës. Në bazë të tyre – unë vetë kaloj pothuajse çdo dy a tri ditë, po nuk jam profesional dhe nuk kam dalë asnjëherë me e kqyrë nëse uji i rrugës hyn në kanal apo ecën rrugës. Në baza të tyre, po thojnë që, kur ka pas tash në kohët e fundit që ka ra një troh shi, uji nuk po hi në kanal, por po ecën rrugës. Edhe ma herët një herë e kam potencue që duhet projekti të bëhet, edhe kubëzimi atëherë të ngrihet ma lart, pasi që veç kanali ka shkue ma lart sesa kubëzat. Apo të bëhet edhe një fond tjetër që të jetë projekti i finalizuar si duhet. Këto ishin pyetjet e mia, shpresoj në mirëkuptim! Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, për mediat, përshëndetje për kryetarin tonë të komunës, zonja dhe zotërinj, qytetarë të nderuar, zoti kryetar, sot kam disa pyetje për ju. Së pari, pyetja ime e parë, për të cilën do të insistoj, është: nëse mund të vini këtu dhe të na shpjegoni më mirë, për çfarë kemi paguar Human Care? OJQ-në Human Care, e cila deri më tani, sipas llogaritjeve të mia, na ka marrë rreth 500.000 euro. Për cilat shërbime konkretisht e kemi paguar këtë organizatë? Së dyti, zoti kryetar, a po i mirëmban dikush rrugët tani gjatë verës? Gjatë kësaj kohe kam pasur mundësinë të ec në territorin tim dhe kam parë që rrugët janë në gjendje katastrofale. Janë të mbuluara nga të gjitha anët, dukshmëria është e dobët, dhe e dimë se frekuenca e qarkullimit në këtë periudhë kohore është më e madhe, dhe ekziston rreziku i ndonjë aksidenti, madje edhe me pasoja fatale. Së treti, zoti kryetar, tre mbledhje më parë më premtuat që do të më thërrisnit për të parë ato pesë automjete që i bleu z. Behar Brenoli. Kam ngritur këtë çështje vazhdimisht për blerjen e autoambulancave në Qendrën e Mjekësisë Familjare. Një herë i keni sjellë veturat këtu për t'i treguar, por unë po insistoj për ato pesë vetura që i bleu Behar Brenoli prej kur erdhët ju në pushtet. Në vitin 2021 janë blerë tri autoambulanca të reja, në vitin 2022 dy të tjera. Unë insistoj që t'i shoh fizikisht ato pesë vetura. Edhe pse në vitin 2021 nuk keni qenë përgjegjës për blerjen si kryetar, e keni trashëguar gjithë pasurinë komunale dhe dua t'i shoh ato pesë automjete. Ju nga ai vend më premtuat që do të më thërrisni, por kanë kaluar mbi njëqind ditë dhe ende nuk më keni ftuar. Më tej, z. Kryetar, gjatë fushatës suaj zgjedhore kam marrë një broshurë që ia keni shpërndarë popullit goran në Gora, ku zotoheni që do të punësoni komunitetet

jo-shumicë në mënyrë të barabartë. Për katër vite që po eci në këtë ndërtesë të administratës komunale në Dragash, kam parë që keni punësuar qytetarë nga Opoja, por nuk kam parë asnjë goran që është punësuar rishtazi. Ne, z. kryetar, në komunën e Dragashit kemi një Zyrë për Komunitete që sipas statutit ka më shumë kompetenca dhe është e pavarur nga ju. Por, për katër vite dera e saj ka qenë gjithmonë e mbyllur. Aty dikur punonin tre persona, prej të cilëve dy janë pensionuar. Për katër vite në pushtet nuk keni arritur t'i zëvendësoni. E dimë që shefi i mëparshëm i kësaj zyre, z. Mehmet Hamza, ka shkuar në pension, edhe një zyrtar tjetër po ashtu. Por askush nuk është pranuar. Ajo që më irriton më shumë është se kjo zyrë për komunitete shërben si shërbëtoare e juaja për t'ju paraqitur veten si njeri që përkujdeseni për komunitetet jo-shumicë. I preferuari juaj, shefi i kësaj zyre që e mbron më së shumti, nuk ndodhet asnjëherë në vendin e punës. As sot nuk është aty. As dje nuk ka qenë. Në këto katër vite nuk kam parë derën e hapur të kësaj zyre më shumë se dy herë. Edhe pse kjo zyrë paraqitet si ajo që kujdeset më së shumti për qytetarët. Pika tjetër, z. Kryetar, në mbledhjen paraprake të Komitetit për Komunitete, si keni mundur t'i lejoni Uzair Hamzës të thotë gjithë ato fjalë të turpshme? Para festës së Gjurgjovit që ju e organizuat, si mundët t'i lejoni atij të flasë me atë gjuhë urrejtjeje? Kam pritur, kam marrë procesverbalin dhe ajo që ka thënë ai në këtë foltore më vjen turp ta përsëris. Ka qenë nxitje e urrejtjes ndëretnike. Fjalët që i ka thënë këtu janë për nxitje të urrejtjes ndëretnike. Pse nuk e qortuat që të mos flasë ashtu dhe pse nuk ia kujtuat se është obligimi i tij të qetësojë situata të tilla? Duhej ta mësonit këtë, zoti kryetar. Nëse dikush tenton ta prishë bashkëjetesën ndërmjet komuniteteve, obligimi i Uzeir Hamzës dhe Zyrës për Komunitete është të shkojë te palët dhe në mënyrë të qetë ta rregullojë situatën, jo ta përkeqësojë. E dini për çfarë e kam fjalën. E kam fjalën për fjalët rreth “Arkanit” dhe të tjera që i ka thënë në këtë foltore. Kjo është nxitje e urrejtjes dhe e intolerancës ndëretnike. Dhe kjo nuk duhet të ndodhë nga një shef i Zyrës për Komunitete. Mund të ndodhë nga kushdo tjetër, por jo nga ai. Ai ka për detyrë ta parandalojë këtë. Pse i keni dhënë aq shumë kompetenca, zoti kryetar? E kam gjetur procesverbalin. Kam pasur durim të pres dy muaj që ta publikoni procesverbalin, sepse dyshoja se do ta fshihnit ose ndryshonit. Ju e keni mbrojtur atë katër vite. Nuk e di me çfarë ju ka ndihmuar, por e ka shkatërruar popullin dhe të gjitha komunitetet. Ai ka për detyrë të mbrojë interesat edhe të komunitetit shumicë. Çfarë ka bërë? Me ndihmën tuaj, nga ajo Zyrë ka mbetur vetëm një printer dhe një kompjuter, asnjë staf. Zyra e tij është gjithmonë e mbyllur, qytetarët vijnë dhe kthehen mbrapsht. I keni dhënë të drejtë të vendosë se kujt do t'i ndërtohen shtëpi për të kthyerit. I keni dhënë dorë të lirë që të vendosë për

gjithçka. Dhe keni krijuar kaos. Keni bërë të njëjtën gjë edhe me Komitetin për Komunitete përmes z. Miralem Rahta, por kjo nuk është aq tragjike. Në atë Komitet, z. Kryetar, ne kemi... Kini pak durim, z. Kryetar. E di që fjalët e mia ju prekin dhe nuk mund të dëgjoni, por të paktën dëgjoni nga mirësjellja. Nuk pres që të bëni ndonjë gjë. Por të paktën nga mirësjellja. Në Komitetin për Komunitete kishim...Znj. Kryesuese, do t'i shfrytëzoj edhe ato dy minuta...

Arijeta Skeraj: Atëherë, Nedžmidin, ke dalë për ekzekutivin me folë, fol, bëni pyetje. Jo, as edhe dy minuta, ke kalue shumë. 11 minuta, mundesh me i kqyr edhe mediat. Ajo është krye, kur t'i them unë është ndalë, është ndalë!

Nedžmidin Sejdilar: Zonja kryesuese, unë po e shfrytëzoj të drejtën time me Rregullore, po i harxhoj edhe qato dy minuta edhe unë dal jashtë.

Arijeta Skeraj: Dëgjo, ti dhjetë minutshin e ke bo, mundesh me u ulë, dy minutshi pastaj të takon. Ti tash ke me u ulë, kur të dalë kryetari e ta japë përgjigje, i ke edhe dy minuta. Nuk t'i lejoj ty dy minuta më shumë! A di dikush tjetër me e marrë fjalën?

Arijeta Skeraj: Të lutem, Nedžmidin! Të lutem! Atëherë, pasi asambleisti nuk po e ndërpret fjalën, e ndërpres seancën! Shihemi në seancat tjera! Faleminderit!